Dr.sc. Zehadin GASHI

BARNAT

UDHËZUES PRAKTIK PËR TË GJITHË

Qershor, 2011
PRISHTINË

Dr.sc. Zehadin GASHI

BARNAT

UDHËZUES PRAKTIK PËR TË GJITHË

Qershor, 2011
PRISHTINË

Dr.sc. Zehadin GASHI

BARNAT - UDHËZUES PRAKTIK PËR TË GJITHË

Recensentë:

Prof. dr. sci. Gjergj MINGA,
Fakulteti i Mjekësisë, Tiranë

Prof. Asoc. Dr. Ledjan MALAJ
Fakulteti i Mjekësisë-Departamenti i Farmacisë, Tiranë

Lektor:
Shefajet BERISHA

Korrektor*:*
Mr.sc. Ismaijl Shurdhaj

Përgatitja kompjuterike:
Drilon Gashi

Botues:
"FIDANI", Prizren

Të nderuar lexues

Duke parë thellë nevojën për një udhëzues praktik të përdorimit të barnave dhe pamundësinë materiale për ta botuar librin komplet, po jua paraqes një pjesë të librit (libri ka mbi 800 faqe) me shpresën se, në një kohë të shpejtë, do ta botoj të tërin. Në fakt, pjesa më e madhe e këtyre të dhënave është nga librat paraprakë, vetëm se tashti botohen të pasuruara dhe të plotësuara me të dhënat më të reja . Në mbledhjen e këtyre të dhënave kanë kontribuar shumë kolegë, si: Shaip Krasniqi, Arianit Jakupi, LedjanMalaj, Shengyn Spahiu etj., duke ofruar përvojat e fituara në Austri, Itali, Greqi dhe Turqi.

Shpresoj se kjo paraqitje e shkurtër do t'i plotësojë, sadopak, nevojat për t'u informuar me të dhënat e domosdoshme lidhur me përdorimin e drejtë të barnave. Sidomos do të jetë një udhërrëfyes për farmacistët dhe për mjekët e rinj, të cilët janë në hapat e parë të profesionit. Gjithashtu shpresoj se libri do t'i përmbushë kërkesat e të gjithë atyre që kanë nevojë ta përdorin. Materiali është paraqitur shkurtimisht, me qëllim që, shpejt dhe lehtë, të merren informacionet e nevojshme lidhur me përdorimin e barnave.

Problemet që ndeshen gjatë përdorimit të barnave, si: mënyra e përdorimit, njohja me faktet anësore, përdorimi i tyre nga shtatzënat, fëmijët dhe pleqtë, ndikimi i tyre në rezultatet laboratorike etj., shtrojnë nevojën e informimit të drejtë për përdorimin e tyre. Në këtë drejtim pres edhe vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat tuaja që në të ardhshmen përmbajtja e lëndës të plotësohet me të dhëna të reja.

A u t o r i
zehadingashi@yahoo.com

P A R A T H Ë N I E

Ruajta dhe forcimi i shëndetit në përgjithësi, si zgjidhjet e problmeve shëndetësore në veçnti, janë bërë objekt jo vetëm i shkencave mjekësore e farmaceutike, por i gjithë shoqërisë njerëzore dhe qelizave bazë të saj – familjeve dhe bashkësive njerëzore, i të gjitha institucioneve dhe mekanizmave të shoqërisë njerëzore. Në epokën e sotme, në fillimin e dekadës së dytë të mijëvjeçarit të tretë, informacioni shëndetësor mjekësor e farmaceutik është rritur dhe vazhdon të rritet me ritëm të shpejtë. Por është bërë shumë i akceptueshëm, më i vetëdijshëm nevoja në zbatimin e tij. Ky informacion, nga njëra anë, është bërë edhe shumë i kërkuar nga ana e njerëzve, të cilët duan të dinë më shumë për shëndetin e tyre, për mbrojtjen e forcimin e tij, nga ana tjetër, është bërë një nga detyrat themelore të të gjitha hallkave të infrastrukturës së shërbimit shëndetësor dhe shërbimeve të tjera, që drejtpërdrejt apo tërthorazi kanë të bëjnë me shëndetin e njerëzve. Sot, sidomos, hallkat e infrastrukturës së shërbimit shëndetësor, mjekësor dhe farmaceutik midis detyrave më thelbësore e kanë dhënien e informacionit mbi shëndetin dhe ruajtjen e tij pë ta rritur kulturën shkencore shëndetësore të njerëzve të grupmoshave, të profesioneve, të niveleve kulturore të ndryshme, të zonave gjeografiko-ekonomike të ndryshme etj. Dhe, ky informacion për të cilin etja e njerëzve është vazhdimisht në rritje, duhet të jetë në të njëjtën kohë sa më i thjeshtë, më i kuptueshëm si dhe sa më bashkëkohor.

Është e kuptueshme se një vend të rëndësishëm në tërësinë e këtij informacioni që përbënë edhe thelbin etij edukues e praktik që nga indikacionet dhe vlerat e përdorimit të tyre, duke vazhduar me informacionin sa më shkencorë por edhe sa më të thjeshtë të kuptueshëm mbi mundësitë e përdorimit apo dhe të keqpërdorimit të tyre, me ndjekjen e monitorimin e veprimit të barnave dhe të rezultatit në raport me kohën

mënyrën e dhënies, me sinergjizmin dhe antagonizmin e tyre, me regjimin dietik dhe jetësorë të përditshëm që, të paktën të mos ndikojë negativisht mbi veprimin e barnave. Ky informacion është bërë sot, sa i domosdoshëm, aq dhe i kërkuar nga njerëzit edhe për vetë kundërthëniet dhe vështirësitë që e shoqërojnë shoqërinë e sotme, si në të gjitha fushat e jetës edhe në fushën e shëndetësisë. Midis këtyre kundërthënieve, problemeve e vështirësive, po përmendim p. sh. çmimet e barnave që janë rritur. Mbizotërimi, i interesit ekonomik mbi atë shëndetësor e njerëzor që shfaqet herë pas here, kushtëzon largimin nga profesionaliteti dhe njerëzorja. Krijimi i besimit të tepruar tek shumë njerëz se barnat mund t'i përdorin për vete dhe për familjarët e fëmijët e tyre pa u vizituar tek mjeku dhe pa u këshilluar prej tij, duke u bazuar në një informacion të thatë, krejt të pamjaftueshëm ose dhe më keq, në një këshillë inkompetente të një miku apo çdo lloj njeriu tjetër e vëjnë jo rrallë fatin e njeriut sidomos të sëmurët në një udhëkryq të rrezikshëm.

Për këto arsye, ne theksuam pak më lart se në tërësinë e informimit shëndetësor, një vend të rëndësishëm zë informacioni për barnat. Kjo edhe për vetë faktin (me të cilin mund të jetë përballuar çdo njeri) se në shumë raste njeriut i duhet të ndërhyjë me barna në raste sëmundjesh e sidomos urgjencash tek vetja e vet e familjarëve apo miqve të vet. Për tejkalimin e rreziqeve të mundshme, për të siguruar vetëm dobinë dhe për të shmangur dëmet duhet të rritet informacioni në fushën e përdorimit të barnave. Me këtë synim u përgatit kjo përmbledhje nëpërmjet të së cilës autori përpiqet ti jep lexuesit, njeriut që dëshiron të rritë njohuritë e veta, pra dhe mundësitë për të mbrojtur më mirë shëndetin e vet, njohuritë parësore për përdorimin e mundshëm të barnave që mund të merren në rast nevoje edhe pa u vizituar te mjeku, derisa të krijohet mundësia e takimit me mjekun. Shpresojmë, në këtë mënyrë, libri të ndihmojë në tejkalimin e rreziqeve të

mundshme të përdorimit të asaj kategorie barnash, që mund të përdoren fillimisht, edhe pa u vizituar te mjeku.

Risi në këtë botim është se autori ka përmbledhur përvojën e vet hulumtuese praktike pastaj ka bërë grumbullimin-ngjizjen e të dhënave edhe të tre librave të më parshëm aq më tepër duke pasur parasysh se me vite autori udhëheqedhe provimin praktik profesional për farmacistët e posadiplomuar ku ka nxjerrë në pah shumë vështërsi me të cilat ballafaqohen ata në punën praktike receptuale.

Vlen të theksohet paraqitja koncize dhe qartë e mënyrës praktike të përdorimit të barit, këshillat dhe udhzimet lidhur me përdorimin e tijë, udhëzimet për pështkrimin e saktë të tyre, ndikimin e barnave në rezultatet laboratorike, njohjen me të gjitha barnat që ndodhen në tregun botëror-farmaceutik etj.

Kjo në një farë mënyre ka mbushur zbrastirën e njohurive që jo vetëm mjeku, farmacisti por edhe i sëmuri duhet të dijë për barnat në përgjithësi dhe për barnat që mjeku e farmacisti i përshkruajnë dhe i udhëzojnë, për përdorimin korekt e të sigurt të tyre. ***(P a r a t h ë n i a është e librit të kompletuar)***

Recensentët

LIDHJET: I SËMURI-MJEKU-FARMACISTI DHE

DOMOSDOSHMËRIA E AFRIMIT TË TYRE

Barnat ndihmojnë në mjekimin apo lehtësimin e shumë sëmundjeve, mirëpo në qoftë se nuk shfrytëzohen drejt dhe racionalisht, jo vetëm që nuk do ta kenë efektin e tyre, por përkundrazi mund të shkaktojnë dëme në shëndet. Për këtë arsye është e udhës të dihet se për një mjekim të suksesshëm është e nevojshme të forcohen lidhjet midis të sëmurit, mjekut dhe farmacistit. Këto lidhje mund të përfytyrohen si një urë, e cila ka katër harqe: të sëmurin, mjekun, farmacistin dhe përsëri të sëmurin. Këto harqe kanë domethënie dhe funksion të veçantë.

Kjo urë me katër harqet e veta paraqitet kështu:

I sëmuri - duhet t'ia tregojë mjekut gjendjen reale të shëndetit, në mënyrë që mjeku të ketë një anamnezë (histori të sëmundjes) të qartë. Nga ana e të sëmurit ky veprim duhet të bëhet pa frikë dhe pa mbajtur fshehtësi.

Mjeku **-** duke u bazuar në parimet e etikës mjekësore, duhet të veprojë me kohë dhe me vendosmëri për përcaktimin (diagnostikimin) sa më të saktë të sëmundjes, duke e hulumtuar atë pa u ndikuar as nga i sëmuri, as nga dhënia e barnave.

Farmacisti **-** duke pasur parasysh se është stacioni i fundit ku bëhet verifikimi i drejtë i shkruarjes së barnave dhe udhëzimit për mënyrën e përdorimit të tyre, duhet të mbështetet në disa kritere optimale (të përshtatshme) të mënyrës së dhënies së barnave. Këtu në radhë të parë bën pjesë leximi shumë i kujdesshëm i reçetës, mandej, mosndryshimi i mjekimit pa u konsultuar me mjekun dhe me të sëmurin si dhe sqarimi i përshtatshëm i mënyrës së përdorimit të barnave. Sidomos, duhet pasur parasysh, barnat,

të cilët ndodhen në listën e barnave që jepen vetëm me reçetë mos t'i japë pa reçetë.

I sëmuri në qoftë se nuk i respekton këshillat e mjekut si dhe të farmacistit lidhur me mënyrën e drejtë të përdorimit të barnave, nuk do ta ketë suksesin e pritur të mjekimit. Sidomos do të bëjë gabimin më të madh në qoftë se merr barna, të cilët nuk ia ka dhënë mjeku dhe nuk e ka udhëzuar farmacisti.

Çdo veprim, i cili del jashtë kësaj lidhjeje të ndërsjellë të domosdoshme nuk do të çojë te mjekimi i përshtatshëm dhe i kërkuar, por do të ketë pasoja të rënda.

Këtë formulim e përmendëm për arsye se sot ka mjaft raste kur shkruhen dhe jepen barna pa kritere të mjaftueshme dhe se përdorimi i tyre nga ana e të sëmurit bëhet me kujdes të pamjaftueshëm.

Shpresoj se këto udhëzime do të respektohen me përpikëri, sepse në këtë mënyrë vendoset ura e sigurt dhe e domosdoshme e bashkëpunimit - **i sëmuri-mjeku-farmacisti**. Kjo urë bashkëpunimi do të japë rezultatin më të mirë të mjekimit, përkatësisht realizimin më me sukses të mjekimit lidhur me përdorimin e drejtë të barnave.

Ky manual (doracak) do të jetë një ndihmë e duhur për lexuesit (përdoruesit e barnave me ose pa rekomandim të mjekut), rreth ruajtjes së shëndetit të tyre dhe përdorimit të drejtë (racional) të barnave.

LIDHJET MJEK – FARMACIST DHE VENDI I TË SËMURIT

Të shprehemi më konkretisht rruga më e zakonshme kur sëmuhemi ne apo pjesëtarët e familjes, të afërm, shokë e miq është të paraqitemi tek mjeku. Ai bën vizitë korrekte e të vëmendshme mjekësore, e gjurmon historinë e sëmundjes qoftë nga i sëmuri apo familjarët e të afërmit, gjykon për shenjat e mundshme prezente, pas të cilave arrin në përfundim logjik mbi sëmundjen (apo sëmundjet) e mundshme nga e cila vuan dhe vendos për mjekimin e tij.

Në rast se ai është në gjendje të rëndë apo ka një sëmundje që përbën urgjencë mjekësore, ndërmerrr masat për trajtim të menjëhershëm me barnat e emergjencës që i ka në dispozicion, të sëmurin e shtron në spital për mjekim të mëtutjeshëm intensiv dhe të specializuar bashkëkohor.

Në rast se mjeku e sheh të arsyeshme, se gjendja shëndetësore e pacientit nuk është serioze, e dërgon në shtëpi duke i dhënë edhe këshillat përkatëse dhe reçetën për t'i marrë barnat e nevojshme.

Si në rastin e parë, të urgjencës ashtu dhe në rastin e dytë që do ta quajmë të zakonshëm, është farmacisti i spitalit apo i barnatoreve të qytetit që do të konkretizojë mjekimin e të sëmurit. Është farmacisti që deshifron recetën e dhënë nga mjeku dhe që i jep barnat e duhura së bashku me këshillat përkatëse, aq të domosdoshme për përdorimin e drejtë (racional) të tyre. Ai e këshillon të sëmurin apo familjarin, si duhet t'i përdorë barnat, në çfarë intervali kohor duhet t'i përdorë, si do t'i përdorë lidhur me ushqimin (para, pas apo gjatë ushqimit), cilave kufizime duhet t'u përmbahet për të siguruar një veprim sa më të mirë e më efikas të barit, me çfarë do t'i shoqërojë, si do t'i kombinojë (ndërthurë) barnat me njëri-tjetrin, për çfarë do të ketë kujdes gjatë mjekimit me barna, sidomos lidhur me ndonjë veprim të mundshëm anësor të barnave etj.

Pra edhe farmacisti, në fund të fundit, është një specialist i mjekësisë, siç janë edhe specialistët e tjerë, kardiologë apo pediatër, kirurgë, dentistë etj. Ai në fushën e veprimit të vet, është po aq kompetent sa është edhe kardiologu në punën e vet, apo kirurgu, dentisti etj. Dhe brenda kompetencës që i jep specialiteti i farmacistit, ai kur e sheh të arsyeshme dhe të domosdoshme, konsultohet me mjekun për dozat e dhëna, për barnat që mund të përjashtojnë njëri- tjetrin apo për barnat që fuqizojnë njëri-tjetrin në veprimin e tyre, për barna që kanë të njëjtin veprim, por që kanë emra tregtarë të ndryshëm etj.

Sot kur në përdorim mjekësor janë futur një numër shumë i madh barnash, dhe kur informacioni mbi veprimin e tyre, të afërt apo të largët në kohë, po shtohet me ritme shumë të larta, është e kuptueshme që bashkëpunimi mjek-farmacist është i domosdoshëm. Një industri shumë e madhe, shumë e fuqishme dhe bashkëkohore farmaceutike është vënë në dispozicion të mjekësisë dhe të farmacisë. Në këtë industri, sidomos të firmave farmaceutike të mëdha, funksionojnë dhe sektorë studimorë-eksperimentalë të lidhur me laboratore kërkimore, nga më të sofistikuarit dhe me universtitete e klinika nga më të mirat. Rezultate të punës së këtyre sektorëve janë zbulimi dhe futja në përdorim e barnave të reja, në përputhje me kërkesat e një mjekësie moderne. Dhe, përderisa mjekësia e sotme ka akoma shumë probleme për tu zgjidhur, ka shumë "pse" që kërkojnë përgjigje, detyrat e mjekëve dhe të farmacistëve janë në rritje. Është një rregull i pashkruar: pas përgjigjes që japin shkencat mjekësore dhe farmaceutike për çdo "pse", dashur e padashur lindin "pse" të reja dhe kjo përbën rrugën e pafund të zhvillimit të shkencës në përgjithësi, të shkencave mjekësore dhe farmaceutike në veçanti.

Në tërë këtë rrugë, sa të vështirë aq dhe të dobishme, të dy palët, mjeku dhe farmacisti, kanë të bëjnë me të sëmurin. Nuk është vetëm binomi mjek-farmacist, por janë dy binome të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin: binomi ***mjek - i sëmur*** dhe binomi ***farmacist - i sëmur.*** Për këtë arsye në përdorimin sa

më të efektshëm të barnave janë po aq të interesuar dhe kanë detyra shumë të rëndësishme e me përgjegjësi, si i sëmuri ashtu dhe mjeku e farmacisti. Në fakt, rruga është: i sëmuri-mjeku-farmacisti dhe përsëri i sëmuri.

Po shprehemi edhe më thjesht dhe në mënyrë më konkrete nuk janë të rralla rastet kur i sëmuri (apo familjarët) ndodhen përpara situatave të vështira kur nuk kanë mundësi të takojnë mjekun apo farmacistin. Falë kulturës së tyre të përgjithshme, ku bën pjesë edhe kultura e përgjithshme shëndetësore, që e kanë fituar gjatë jetës (më saktë, që duhet t'a fitojë çdo njeri gjatë jetës), ata duhet të veprojnë për të lehtësuar gjendjen dhe për të "fituar kohë" derisa të takojnë mjekun ose farmacistin. Për këtë, ata mund të kenë në dispozicion në shtëpi apo aty ku ndodhen (në punë etj.) barna të cakatuara, më të përgjithshme që janë "ndihmëse" shumë të çmuara për kapërcimin e situatës dhe për fitimin e kohës.

Shkurt, i sëmuri apo familjari i tij, ju të nderuar lexues, në këtë kohë, dashur apo padashur do të bëheni edhe mjekë edhe farmacistë, sepse edhe do të mendoni se çfarë bari do të merrni ju apo njeriu i sëmurë i familjes, dhe do ta përdorni atë bar që ndoshta e keni në "barnatoren" e vogël të shtëpisë.

Sigurisht në një kohë të dytë, mundësisht sa më shpejtë, do të kërkoni të takoni mjekun për të kaluar urën e domosdoshme me katër harqe**: *i sëmuri-mjeku-farmacisti-i sëmuri,*** e cila garanton edhe suksesin më të mundshëm, edhe pagabueshmërinë maksimale.

Në raste të tjera, më të "zakonshme" sidomos për sëmundje me karakter të zgjatur jeni ju, që do të jeni mjeku dhe farmacisti i vetes suaj apo familjarit tuaj, pasi të keni marrë prej mjekut dhe farmacistit mjekimin e duhur, sidomos të gjitha këshillat e nevojshme për zbatimin e atij mjekimi. Jeni ju që do të vëreni efektin e mjekimit, në veten tuaj dhe mandej, herë pas here në vizitat periodike tek mjeku do t'i "raportoni" atij gjithçka që keni vënë re gjatë mjekimit të

zbatuar prej jush, bashkë me këshillat që e shoqërojnë atë mjekim.

Sot në botë raportimi lidhur me efektet e barnave paraqet një fushë të rëndësishme të shkencave farmaceutike-mjekësore, të quajtur *farmakovigjilencë*. Për këtë fushë, që për ne deri vonë ishte jo vetëm e paaplikueshme, por edhe e panjohur, bota shpenzon shumë. Arsyet janë të shumta: përcillet efekti i barnave lidhur me mjekimin, përcillen ndryshimet e efekteve anësore (të padëshiruara) të barnave, hulumtohet veprimi i tyre lidhur me efektet e paraqitura etj. Në këtë aspekt arrihen shumë suksese, si: mjekimi i sigurt, parandalimi i veprimeve anësore të barnave, krijimi i mundësisë së hulumtimeve të mëtutjeshme të efekteve të barit, modifikimi i tij me mbështetje në raportimet e fituara, gjetja e barnave të rinj etj.

Ja, pra pse duhen disa njohuri themelore, të thjeshta, por shumë të dobishme për barnat, për regjimin ditor dhe për regjimin e jetës, për disa rregulla që duhet t'i keni parasysh etj. Me fjalë të tjera jeta moderne e sotme, në këtë epokë të një revolucioni shkencor në farmaci si dhe në fushën e mjekësisë, e ka shtruar si detyrë e domosdoshmëri që gjithsecili, të jetë edhe mjek i vetvetes, në radhë të parë për të parandaluar sëmundjet (profilaksia parësore) apo ndërlikimet dhe keqësimet e tyre (profilaksia dytësore), si dhe për të shmangur përdorimin pa vend dhe efektet e padëshiruara të barnave.

PËR ÇKA DUHET TË INTERESOHET E TË KËRKOJË I SËMURI DHE ÇFARË DUHET T'I SHPJEGOJË ATIJ MJEKU DHE FARMACISTI PËR BARIN E DHËNË ?

Meqë shumica e të sëmurëve - pacientëve nuk i marrin barnat në mënyrë të drejtë (madje ka edhe të sëmurë që nuk i marrin fare për shkak të frikës se mund të shfaqen efektet anësore), dhe meqë, gjithashtu, ka raste kur bari nuk vepron aq shpejt sa pritet etj., ka shumë rëndësi që mjeku dhe farmacisti t'u japin këshillat e nevojshme të sëmurëve apo familjarëve të tyre.

Edhe në rast se mjeku apo farmacisti nuk i japin këto këshilla, vetë të sëmurët apo familjarët e tyre duhet të jenë ata që kërkojnë të informohen rreth mënyrës së përdorimit të barnave, efekteve të barnave (të dëshiruara ose të padëshiruara) etj.

Me fjalë të tjera, i sëmuri, para se të marrë një bar, është mirë të dijë ***të veçantat e përdorimit të atij bari.***

Cilat pyetje kanë përgjigje në këtë libër?

1. A është bari që ka përshkruar mjeku i njëjtë ?
2. A gjendet një bar i tillë ?
3. A merret bari para buke apo pas buke?
4. Në cilin termin kohor duhet të merret bari (brenda 24 orëve) ?
5. Sa kohë duhet të përdoret ?
6. Nëse harrohet të merret në terminin e caktuar, si duhet të veprohet ?
7. Për sa kohë duhet të merret(sa ditë, javë, muaj etj.) ?
8. A merret me lëngje, përtypet, gëlltitet në të thatë, mbahet nën gjuhë apo në gojë?

9. A bën të përdoret bashkë me barnat e tjerë ?
10. Gjatë përdorimit të tij a bën të përdoren ushqimet e caktuara ?
11. A bën të ndahet bari ?
12. A mund të shkaktojë alergji ose ndonjë efekt tjetër anësor?
13. A bën të përdoret në kushtet specifike të pacientit (gratë shtatzëna, ushqimi me gji, ngasja e makinës, sëmundjet e ndryshme-veshkët, mëlçi, zemër etj.)?
14. Në çfarë kushte duhet të ruhet?
15. Pas përdorimit- si duhet të veprohet me barin (sasinë) e mbetur etj.?

I. ÇKA JANË BARNAT E NJËJTË DHE TË NGJASHËM?

Të shumtën e rasteve kur pacienti shkon në barnatore, e pyet farmacistin:

1. **A është bari që ka përshkruar mjeku i njëjtë -** (a është me përbërje të njëjtë apo i ngjashëm; nëse është me përbërje të njëjtë dhe ndryshon vetëm emri mbrojtës - i prodhuesit, atëherë e zgjedh se cili prej tyre është më i liri -me çmim më të arsyeshëm). Bari është i njëjtë në kuptim të:

- substancës mjekuese (ampicilina, furesomid-ose kombinime si emalapril+hidroklortiazid etj.),
- formës farmaceutike (tableta, kapsula, suspensioni etj.),
- dozës-sasisë (mg, gr, % etj.)
- ambalazhimit (20 tableta, 16 kapsula, 100 ml etj.).

2. **A është bari i ngjashëm -** Përbërja e barit i takon grupit të njëjtë, p.sh.: vitaminat, mineralet, antihipertenzivët, etj.). Me bar të ngjashëm nënkuptojmë kur bari nuk përmban substancën e njëjtë, mirëpo përdoret për qëllime të njëjta, p.sh.: Vitamina dhe minerale, Antihipertenzivë, Kardiotonikë, Mukolitikë etj.

   Në të gjitha këto raste duhet pa tjetër të konsultohet mjeku, sepse duhet të dihet qartë nëse mjeku barin e përshkruar e jep për qëllime specifike. P.sh.: Shkruan vitamina dhe minerale, mirëpo në përbërjen e barit të përshkruar ai donë të arrin veprimin e ndonjë vitamine ose minerali që në përbërjen e atij bari është specifike-p.sh në dozë të dëshiruar, ose nëse mjeku jep një antihipertenziv ku ai ka diagnostifikuar qartë etiologjinë e atij hipertenzioni p.sh. i shkruan hidroklortiazid dhe ne i japim furesemid ose i shkruan enalapril dhe ne i japim nifedipin. Kjo nuk guxon të zëvendësohet pa konsultën e mjekut.

II. PSE NJË BAR DUHET TË PËRDORET:

1. **Në interval të caktuar kohor - (**në kohën-orën e njëjtë**).** Çdo bar duhet të merret në kohë të caktuar, sepse koha e caktuar i siguron organizmit sasinë e nevojshme të përqendrimit të barit për atë periudhë të caktuar. Bari e ka kohën e vet të caktuar sa mund të qëndrojë-veprojë në organizëm, sepse pas asaj kohe ai eliminohet nga organizmi ose e humb efektin e vet në organizëm. Kjo ka pastaj si pasojë pamundësinë e tij për të ruajtur veprimin e dëshiruar. P.sh. nëse një antibiotik është i udhëzuar të merret në çdo 6 orë dhe ai merret në çdo 8 ose 12 orë, mikroorganizmi do të luftohet vetëm 6 orë dhe pas gjashtë

orësh ai do të jetë i lirë dhe do të ketë mundësi për t'u këndellur dhe përgatitur për dozën e ardhshme me çka bëhet rezistent – i aftë për të përballuar sulmet e dozave të ardhshme dhe mjekimet me atë bar në të ardhmen - kjo do të thotë se mikroorganizmi ka krijuar sistemin mbrojtës nga ai bar dhe bari nuk ka efekt.

2. **Në dozë sasi të caktuar -** (vetëm sa ka caktuar mjeku). Marrja e barit në dozë të caktuar është me rëndësi të madhe, sepse doza e barit llogaritet asisoj që bari të jetë në përqendrim të mjaftueshëm për të luftuar sëmundjen. Nuk bën të ketë shmangie të dozës së barit, qoftë ajo edhe dozë e vogël (p.sh. mikroorganizmat përballojnë atë dozë me çka shkakton rezistencë dhe bari jo se nuk arrin efektin e vet, por mikroorganizmat bëhen imunë ndaj tij edhe në të ardhmen - dhe bari s'do të ketë efekt, ose nëse marrim dozë të vogël të ndonjë bari antihipertensiv, kardiotonike etj., bari nuk e ka fuqinë e veprimit dhe kështu nuk e arrin veprimin e dëshiruar dhe sëmundja komplikohet më tepër - shpeshherë edhe humbet besimi edhe te vetë bari i përdorur.). Gjithashtu edhe e marrja e barit në doza më të larta nga ajo që përshkruhet, mund të shkaktojë dyfishim të veprimit deri te shkaktimi i intoksikimeve dhe helmimeve me pasoja të rënda deri tek ato fatale.
3. **Në periudhë të caktuar kohore -** (sa kohë - ditë, javë, muaj, vite dhe gjatë gjithë jetës). Të gjithë barnat kanë karakteristikat e veta të përdorimit. Disa, siç janë analgjetikët, spazmolitikët, përdoren vetëm derisa të pushojnë dhimbjet (sepse veprimi i tyre është që të ndalojnë dhimbjen), antibiotikët duhet të përdoren deri sa të eliminojnë-zhdukin mikroorganizmat-bakteret (sepse, nëse ndërpriten para kohe mikroorganizmat nuk zhduken plotësisht dhe bëhen recidivë -

shkaktojnë rezistencë), disa barna deri sa të stabilizojnë gjendjen e caktuar shëndetësore (laksativët, antipiretikët etj.), ndërsa disa të tjerë duhet të përdoren gjatë gjithë jetës sepse funksionet të cilat ata i kryejnë për organizmin, janë të nevojshme gjatë gjithë jetës dhe pa ta jeta është e pamundur (siç është rasti me antidiabetikët, antihipertensivët etj.; kuptohet atëherë kur ka diagnostifikim të qartë sëmundja). Përdorimi i tyre gjatë gjithë jetës është i detyrueshëm, sepse mospërdorimi i rregullt i tyre mund të shkaktojë situata të rënda e edhe vdekjen.

4. **Para ushqimit -** (disa barna janë të tretshëm në ujë dhe më lehtë resorbohen pa prezencën e ushqimit, siç janë vitaminat hidrosolubile, ose mekanizmi i veprimit të tyre është që të veprojnë në receptorët e ndryshëm, të cilët tajojnë produkte që ndikojnë në gjendjen e lukthit, siç është rasti me disa antiulcerikë-omeprazolë, që veprojnë në receptorët H_2 dhe pengojnë krijimin e acidit klorhidrik).
5. **Pas ushqimit** - disa barna siç janë antireumatikët, analgjetikët, salicilatet në bark të zbrazët mund të shkaktojnë korezion të mukozës së traktit digjestiv dhe mund të shkaktojnë dëmtimin e saj-sidomos të Ulcera. Gjithashtu pas ushqimit ose me ushqim përdoren edhe disa antacide, të cilat veprimin e vet (lokal) e kanë në neutralizimin e acidit klorhidrik, i cili krijohet pas marrjes së ushqimit, siç është hidroksidi i aluminit etj.).
6. **Me ushqim** - disa barna treten me mirë në yndyra dhe resorbimi i tyre është më i lehtë siç është rasti me vitaminat liposolubile, disa barna siç janë antidiabetikët duhet të veprojnë në ushqimin e përdorur-metabloitzmin e karbohidrateve-glukozës (sheqerit me të cilën ushqimi është i pasur etj.),

7. **Pa ushqim të caktuar** - disa barna bashkëveprojnë me ushqimin e caktuar duke krijuar komplekse të patretshme (të cilat nuk resorbohen) siç është rasti i tetraciklinave me qumështin dhe dervivatet e qumështit, anksiolitikët, sedativët etj. me alkoolin.)
8. **Në mbrëmje** - (anksiolitikët, sedativët-veprimi i tyre shkakton molisje dhe gjumë, antilipemikët-veprimi i tyre është më i mirë për të eliminuar yndyrat e marra gjatë ditës etj.)
9. **Ndaras nga bari tjetër** - (shumë barna për shkak të vetive të tyre fiziko-kimike ose mekanizmit të veprimit nuk duhet të merren në të njëjtën kohë, p.sh., aspirina me indometacinën, antitusikët (që ndalin kollin)me ekspektorantët (nxitin kollitjen për të pastruar sekretin), Aspirina me antikoagulantët etj.).
10. **Në mëngjes** - (diuretikët-për të mënjanuar urinimin natën, diabetikët për të vepruar gjatë marrjes së ushqimit brenda ditës etj.).
11. **Të shkrihet në gojë** - për shkak se janë të formuluara asisoj që duhet të veprojnë duke u shkrirë në hapësirën gojore siç janë oribletet.)
12. **Të mbahet nën gjuhë** -lingualetet - për shkak se janë të formuluara asisoj që të resorbohen dhe veprojnë më mirë dhe më shpejt duke i përdorur nën gjuhë, bari anashkalon traktin digjestiv ku mund të humbin veprimin siç janë disa hormone etj.)
13. **Të gëlltiten** - film-tabletat, kapsulat etj. sepse ato kanë formulim të tillë që duhet të treten në vend të caktuar të traktit digjestiv ose janë të mbrojtura deri në vendin e caktuar të traktit gastrointestinal, që të mos shkatërrohen ose të mos shkaktojnë probleme gjatë aplikimit deri te vendi i resorbimit.)
14. **Të pihet i tëri pa u thyer-grimcuar** - (film-tabletat, kapsulat etj. Sepse, ato janë të formuluara asisoj që duhet të treten në

vend të caktuar të traktit digjestiv ose janë të mbrojtura deri në vendin e caktuar të traktit digjestiv, që të mos shkatërrohen ose të mos shkaktojnë probleme gjatë aplikimit deri te vendi i resorbimit.).

15. **Të përdoret me pak ujë – lëngje** (kapsulat ngjiten në mukozën e gojës, të fytit, të zorrëve -ku vonohet veprimi dhe paraqiten probleme të gëlltitjes, tabletat vështirë gëlltiten, pluhurat vështirë përdoren të patretura etj.). Në disa raste marrja e tepruar e ujit me barnat nuk është e mirë, sepse sjellë deri te prishja e baraspeshës acidobazike, që për pasojë ka komplikimet e ndryshme. Për këtë arsye është mirë që për çdo bar veç e veç të jepen udhëzimet rreth përdorimit dhe sasisë së caktuar të ujit.
16. **A duhet të ndërpritet marrja e barit menjëherë, apo gradualisht ose të vazhdohet edhe disa ditë pas ndërprerjes së shenjave-simptomave të sëmundjes** - (një grup i barnave si antibiotikët duhet të merret në periudhë të caktuar - nuk duhet të ndërpritet pasi që sëmundja duket se është shëruar, ndërsa disa barna si antiepileptikët, barnat kardiovaskularë, sedeativët/hipnotikët duhet të ndërpriten duke e marrë në konsideratë një ulje shkallë-shkallë (ngadalë) të dozës para se ata të ndërpriten plotësisht).
17. **Nëse bari nuk jep efekte të mira (efekte anësore) ose pas marrjes së barit sëmundja nuk mjekohet, si duhet të veproj** - (te efektet anësore, të cilat janë vërtetuar klinikisht, nëse nuk paraqesin problem të theksuar, bari nuk ndërpritet - sqarohet për të cilat simptome nuk ndërpritet terapioni, por nëse japin simptome të cilat nuk janë të përshkruara, bari duhet të ndërpritet menjëherë dhe pacienti duhet t'i drejtohet mjekut ose farmacistit. Nëse pas marrjes së barit nuk ndiejmë përmirësime, barin nuk duhet ta ndërpresim as ta

zëvendësojmë me ndonjë bar tjetër, por duhet t'i drejtohemi mjekut dhe farmacistit për sqarime dhe udhëzime të mëtutjeshme. Farmacisti dhe mjeku janë të obliguar që pacientit t'i japin informacionet bazë, si: cilët shenja të përmirësimit do të pasojnë pas marrjes së barit, për sa kohë do të shihet efekti, cilat janë efektet anësore që mund të shfaqen, si njihen ato, sa zgjasin, si të veprojmë ndaj tyre në rast se shfaqen, çka nuk bën të veprohet gjatë marrjes së barit (ngasja e makinës tek anksiolitikët, mosndërprerja para kohe tek antibiotikët, shtatzënësia, ushqyerja me gji e fëmijës (për barnat që dëmtojnë frytin), të mos merren disa ushqime të caktuara, përdorimi para, gjatë dhe pas ushqimit, sa kohë duhet të përdoret bari, si duhet të veprojmë me barin pas përdorimit etj. etj.).

18. **Si duhet të veprohet me barnat kardiovaskularë gjatë kohës së përdorimit të tyre** - (është e udhës që të sëmurët kardiovaskularë, me shtypje të lartë të gjakut, me sheqer, me yndyrë etj., kohë pas kohe në barnatore të matin tensionin e gjakut, sheqerin etj., në mënyrë që të monitorohet veprimi i barit dhe të stabilizohet sëmundja). Në këtë mënyrë pacienti do të mbajë nën kontroll sëmundjen dhe do të parandalojë aksidentet e mundshme fatale (sulmi në zemër, në tru), të cilat do të ndodhnin si pasojë e mosmarrjes së drejtë të barit (sasi-dozë, interval kohor, kombinim me barnat e tjerë ose me ushqimin), e situatave konfliktuoze (depresionit) etj.

19. A duhet me të gjithë barnat të fillohet me doza të larta si dhe a duhet të gjithë barnat të ndërpriten menjëherë në dozat e marra?

Duke pasur parasysh mekanizmin e veprimit, kohën e gjysmëeliminimit, ndryshimet metabolike dhe fiziologjike që ndodhin si në fillimin e përdorimit të barit ashtu edhe në ndërprerjen e tij, etj., ndikojnë shumë gjendjen e përgjithshme të sëmundjes dhe organizmit në përgjithësi. Jo me të gjitha barnat duhet të fillohet menjëherë në doza të larta ose të ndërprite bari menjëherë e jo në mënyrë graduale.

Për të qen më praktik po japim grupet e barnave me të cilët fillimi i mjekimit është gradual shkallë-shkallë dhe grupi tjetër i barnave të cilët duhet të ndërpriten shkallë - shkallë.

Para se të ndërpritet plotësisht marrja e barnave, fillon ulja e ngadaltë e barnave:

Amfetaminës, antiepileptikëve, antidepresivës, antipsikotikëvet etj.

Barnat kardiovaskulare - klonidina**,** metildopa**,** beta-bllokuesit**,** vazodilatatorët:

1. Kortikosteroidet;

2. Hipmotikët/Sedativët: benzodiazepinët**,** barbituratet;

3. Opiatet.

Barnat që kërkojnë rritje të ngadalshme të dozës:

Antidepresivët treciklikë (efektet antikolinergjike), disa antiepileptikë (karbamazepina, acidi valproik), antiparkinsonikët me bazë dopa, inhibitorët ACE te pacientët që përdorin diuretikë, agjentët bllokues të receptorëve alfa në hypertension (orthostasis), disa barna hormonalë (kortikosteroidet, levotyroksina), kripërat e arit në reumatizëm, përzierjet për sensibilizim, opiatet etj.

L[30,31,32,42,43,63,71]

ÇFARË BARNASH JANË NË PËRDORIM NË MJEKËSINË E SOTME, KATEGORITË E TYRE

Për të kuptuar se ç'është një bar, çfarë përfaqëson ai dhe përse është i dobishëm, janë bërë përpjekje për të përcaktuar në radhë të parë se ç'farë është bari. Ka përkufizime të ndryshme dhe pothuajse të gjithë kanë diçka të mangët, diçka që ju mungon. Më i plotë është përkufizimi i barit i dhënë nga Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH). Sipas OBSH-së: Bar është çdo lëndë ose prodhim që shfrytëzohet ose mund të shfrytëzohet për të modifikuar (ndryshuar) ose për të hulumtuar funksionet fiziologjike të sistemeve dhe organeve të veçanta të organizmit në gjendjet patologjike, në synimin që kjo të vlejë për të mirën e të sëmurit që e "pranon" atë lëndë.

Bari është një lëndë (substancë), me natyrë bimore, shtazore , minerale apo kimike-sintetike dhe në përgjithësi mund të përdoret për tri qëllime të mëdha:

- për mjekimin e sëmundjeve dhe traumave
- për parandalimin e sëmundjeve dhe
- për diagnostikimin e tyre.

Në rast se gjatë përdorimit të barit nuk do të respektohen rregullat e përdorimit të tij, mënyra e përdorimit etj., (shih më lart) ai ka rrezik që të mos veprojë më si bar, por si helm.

Kuptohet se barnat mund të përdoren edhe për të përcaktuar një diagnozë të saktë, ose (kur diagnoza është përcaktuar) për të ndikuar mbi sëmundjen, për ta kufizuar atë mundësisht deri në zhdukjen e saj (pra deri në mjekimin e të sëmurit).

Numri i tyre sot është i madh dhe gjithmonë në rritje. OBSH-ja ka paracaktuar listën e barnave më të domosdoshme (esenciale), që nuk duhet të mungojnë në shërbimet farmaceutike të spitaleve dhe në barnatore, listë kjo që numëron afër 300 lloje barnash.

Është e kuptueshme se barnat e shumta që qarkullojnë sot në botë janë të klasifikuara (ndara) në klasë e grupe të veçanta në bazë të prejardhjes së tyre, përbërjes kimike, fushës kryesore të veprimit në organizëm etj. Klasifikimi më i plotë i barnave që përfshinë edhe rrafshin kimiko-farmaceutik, edhe rrafshin mjekësor-farmaceutik është klasifikimi i dalë nga OBSH-ja. Ai është më i miri, më shkencori dhe më i përdorëshmi për kohën, tani në vigjilje të mijëvjeçarit të tretë. Sigurisht ai ka lënë shtigje dhe madje fton punonjësit e farmacisë e të mjekësisë, për të kërkuar më tej, për ta plotësuar e përsosur vazhdimisht në të ardhmen me zbulime të reja, me përvoja të reja, me koncepte dhe studime të reja.

Sipas këtij klasifikimi barnat janë të ndarë në 14 grupe kryesore dhe vetë kjo ndarje tregon se edhe shërbimi farmaceutik dhe ai mjekësor janë disiplinuar shkencërisht në tërë veprimtarinë e tyre, në të gjitha fushat ku veprojnë. Brenda tyre ka vetëm shkencë, rregull, logjikë, udhëzim për veprim në të njëjtën kohë vlerësim shkencor e ligjor për gjithçka që kryhet si dhe tharm (ngjizje) për zbulime të reja, zbulime të pandërprera.

Është mirë që gjithsecili të ketë një njohuri të përgjithshme mbi grupet kryesore të barnave sipas klasifikimit të sotëm të OBSH-së, pa hyrë në hollësi të nëngrupeve , që duhet njohur në radhë të parë nga specialistët e farmacisë.

Në bazë të Klasifikimit anatomiko-terapeutik barnat janë të ndara në 14 grupe kryesore :

A Barnat që veprojnë në traktin digjestiv dhe në metabolizëm

B Barnat që veprojnë në gjak dhe në organet gjakkrijuese

C Barnat që veprojnë në sistemin kardiovaskular(enë të gjakut, zemër etj.

D Barnat që veprojnë në lëkurë - dermatologjikët

G Barnat që veprojnë në sistemin urogjenital dhe hormonet seksuale

H Barnat sistematike hormonale me përjashtim të hormoneve seksuale

J Barnat për mjekimin e infeksioneve sistematike - antiinfektivët sistematikë

L Barnat për mjekimin e sëmundjeve të rënda - antineoplastikët dhe imunosuprezivët

M Barnat që veprojnë në sistemin e muskujve eshtërorë

N Barnat që veprojnë në sistemin nervor qendror

P Barnat për mjekimin e infeksioneve që i shkaktojnë parazitët - antiparazitikët

R Barnat që veprojnë në sistemin respirator

S Barnat që veprojnë në organet e të dëgjuarit

V Të ndryshme - që nuk futen në ndonjë nga 13 grupet e mësipërme.

ÇKA DUHET TË DIMË NË PËRGJITHËSI PËR BARNAT?

Para përdorimit të barit me rëndësi të madhe është të dihet se çfarë veprimi ka bari:

- A e bën mjekimin e mirëfilltë të sëmundjes në përputhje me shkaqet e saj?
- A e bën ndërprerjen dhe pengimin e sëmundjes ?
- A e bën plotësimin ose zvogëlimin e atyre dukurive apo lëndëve në përputhje me nevojat reale të organizmit ?
- A e bën vetëm zvogëlimin ose ndërprerjen e dhimbjeve dhe shqetësimeve, të pengesave tjera në organizëm?

Ndikimi psikik është një prej faktorëve me rëndësi të suksesit terapeutik - mjekimit. Për shumicën e barnave ndikimi psikik mund të pasqyrohet në përgjigjen e organizmit ndaj barit të caktuar. Kjo në shumë raste mund të çojë deri në ndryshimin e mjekimit prej mjekut kurues. P. sh. në qoftë se të sëmurit i jepet një bar për gjumë dhe ai nuk ka besim rreth veprimit të atij bari, ai në mjaft raste nuk do ta ketë efektin e dëshiruar.

Janë të pakta ata barna, të cilët krahas efektit të veprimit të tyre nuk kanë edhe ndonjë veprim të padëshirueshëm. Veprimi i padëshirueshëm është çdo reaksion i papritur ose i pritur i organizmit, i cili shfaqet gjatë ose pas përdorimit të barit të caktuar. Shkaktarë të këtyre veprimeve të padëshiruara janë shumë faktorë si: veçoritë e ndryshme të organizmit, gjendja shëndetësore e organeve të ndryshme të organizmit, ndërveprimet e barnave në mes veti, por edhe ndonjë gabim i mundshëm i personelit shëndetësor ose i vet të sëmurit. Me t'u

shfaqur një veprim i padëshiruar duhet mënjëherë të bëhet ndërprerja e marrjes së barnave dhe konsultimi sa më i shpejtë me mjekun ose farmacistin.

Barnat, siç u cek edhe më lart, në qoftë se nuk merren në përputhje me "rregullat" dhe këshillat përkatëse, mund të jenë shumë të dëmshme. Për këtë arsye marrja e tyre pa u vizituar te mjeku dhe pa u konsultuar me farmacistin është me shumë rreziqe.

Marrja e pakontrolluar e barnave, sidomos të atyre që veprojnë në disponim apo në gjendjen e përgjithshme të organizmit, në rast pagjumësie, kokëdhembje, etj., mund të çojë në varshmëri ndaj barit të caktuar, çka do të thotë se lind, krijohet një dëshirë e fuqishme për t'a përdorur atë bar vazhdimisht. Kjo dëshirë shndërrohet në një kërkesë këmbëngulëse aq të madhe saqë personat, të cilët e përdorin atë bar, edhe pse janë të vetëdijshëm për veprimet e dëmshme, janë të "detyruar" të marrin atë bar të caktuar.

Për këtë arsye bari duhet të merret në mënyrë të rregullt, çka do të thotë atëherë kur e përshkruan mjeku, në dozë të caktuar dhe në kohë të caktuar.

Marrja e barnave duhet të jetë e kujdesshme sidomos në shtatzënësi, në fëmijëri të hershme, në pleqëri si edhe atëherë kur organizmi vuan nga çrregullime të shumta (sëmundjet e veshkave, mëlçisë, lukthit etj.), për arsye se në këto raste organizmi është më i ndieshëm ndaj veprimit të shumë barnave.

Ruajtja e barnave ka rëndësi të madhe për mbrojtjen e cilësive dhe kualitetit të barit (të ruhet nga temperatura e lartë, nga drita dhe lagështia). Ka rëndësi shumë të madhe edhe "sigurimi" i barnave nga keqpërdorimet e mundshme, sidomos duhet shmangur me çdo kusht marrja e barnave nga fëmijët.

Gjatë ruajtjes ka rëndësi edhe mospërzierja e një bari me një bar tjetër, aq më tepër nuk duhet të merret bari, i cili nuk e ka identitetin e vet(nuk dihet për emrin, dozën etj.). Duhet pasur, po ashtu, kujdes ndaj afatit të përdorimit të barnave. Të

gjitha barnat duhet të jenë të mbyllura mirë, të ruajtura me kujdes, larg lagështisë, larg temperaturave të larta dhe dritës, në paketime e amballazhime të veçanta dhe me emërtime të qarta, si dhe me datë të qartë skadense.

Për të pasur një informacion më të shpejtë po japim tabelën e disa barnave të cilët kërkojnë kushte të veçanta të ruajtjes.

Barnat të cilët duhet të ruhen të mbyllur, janë*:*

▲ - trigonikët me ndikim të fortë në aftësitë psikofizike (Efftil retard, hexifen, haloperidol, karbapin, tegretol, largactil, phenobarbiton etj.);.

§ - barnat të cilët bëjnë pjesë në grupin e drogave dehëse (artane, metadon, thalamonal, valoron etj.;

† - barnat me veprim të fortë;

††-barnat me veprim shumë të fortë;

☠- helmet.

Barnat të cilët duhet të ruhen në temperatura të ulëta, janë:

- vaksinat dhe serumet, imunuglobulinat, insulinat etj.
- nadroparin kalciumi(Fraxiparine)
- barnat si antibethabioptal (neomicin+kloramfenikol), bethabioptal(betametazon+kloramfenikol)
- phenoksimetil-penicilina (ospen susp) etj

Barnat dhe preparatet herbale të cilat duhet të ruhen larg lagështisë: tabletat, drazhetë, pluhrat, çajrat

BARNAT NË SHITJE TË LIRË

Barnat në shitje të lirë (OTC Barnat – nga Over the Counter) janë barna që mund të blihen pa recetë të mjekut, në barnatore, në barnatoret bimore apo edhe në markete (drogeri). Në çdo shtet autoriteti për regjistrim (në Kosovë - Agjencioni për Produkte Medicinale) vendos për çdo bar individualisht se a është për shitje të lirë, apo mund të merret vetëm me recetë. Procesi me të cilin mund të merren barnat në shitje të lirë mundëson një rol më aktiv të pacientit/shfrytëzuesit të mbrojtjes shëndetësore. Gjithashtu sigurojnë qasje më të shpejtë dhe më të lehtë te barnat që mund të merren me siguri pa mbikëqyrje të mjekut. Janë të parapara për të ashtuquajtur barna për vetëmjekim, ndërsa kanë dhe duhet të kenë rol shumë të rëndësishëm në mjekimin e shumë simptomave kalimtare (p.sh. kokëdhembjet, artriti me dhembje, djegësina në stomak, alergjitë dhe ftohjet e thjeshta), të cilat do të mund të "pushonin" pa intervenimin e mjekut. Barnat në shitje të lirë, në të gjitha vendet, janë shpesh barna kundër dhembjes, barna për uljen e temperaturës së trupit, antihistaminikët, dekongjestivët nazalë, barnat kundër kollës – ekspektorantët dhe antitusikët, eupeptikët dhe laksativët, blokatorët e H2-receptorëve, antireumatikët lokalë, antiseptikët, disa pika për sy, preparate të ndryshme bimore, vitaminat dhe mineralet. Është me rëndësi të theksohen disa të dhëna lidhur me barnat, të cilët në shumë vende të botës shiten pa recetë (barnat OTC), por që pacienti ka një kulturë (para se t'i përdorë së pari merr informacione nga fletudhëzimi) duke u siguruar për veprimin dhe efektet e tyre anësore si:

Analgjetikët (joopoidë), përdoren kryesisht për dhimbje muskuloskeletore, dhimbje të dhëmbit, dismenore dhe për antipirezë (kundër temperaturës).. Përdorimi i acidit acetilsalicilik apo i antireumatikëve josteroidë, të cilët gjenden në shitje të lirë, mund të shkaktojë shumë efekte anësore, e që nuk bën t'i marrin pacientët me sëmundje aktive të ulkusit - të thatit (ulcerës) dhe ata që marrin antikoagulantë.

Bllokatorët e H2-receptorëve (si cimetidina etj.) ende gjinden nën mbikëqyrje të posaçme për shkak të intereaksioneve të mundshme me barna të tjerë dhe për shkak të rrezikut të përdorimit të pakontrolluar dhe maskimit të simptomave të sëmundjeve serioze.

Ekspektorantët dhe antitusikët (tusisedativë) janë në përdorim të gjerë për shkak të pohimeve për efikasitetin e tyre, edhe pse kjo nuk është dëshmuar, dhe shpesh preparatet janë të nëndozuara. Për antitusikët ekziston indikacion shumë i qartë – kolla e thatë joproduktive, e që mund të jenë të rrezikshëm te pacientët me astmë apo me sëmundje kronike obstruktive të mushkërive.

Për shkak të përdorimit të gjerë dhe të pakontrolluar është e mundshme edhe "varshmëria" për laksativët, dekongjestivët nazalë etj.

Shumë preparate kundër ftohjes, dekongjestivëve nazalë, supresorëve të oreksit të shtuar, simpatomimetikët që mund të jenë të rrezikshëm te pacientët me diabet, hipertension, hipertreoidizëm dhe me anginë pektorale .

Shumë OTC preparate përmbajnë substancë të njëjtë aktive dhe duhet të kihet kujdes kur të merren më shumë barna, sepse në kombinim me barnat që merren me recetë është e mundur të rritet doza e një përbërësi disa herë dhe të shkaktohen efekte anësore.

Është e qartë se barnat nga shitja e lirë, kryesisht të ashtuquajturat barna "me too", barnat që janë paralele me barnat e tjerë, edhe pse sipas konsumatorëve konsiderohen dukshëm të ndryshëm për nga karakteristikat e tyre ndaj barnave nga grupi i njëjtë ata kanë përmbajtje të njëjtë. Për shembull, ekziston një mori i kombinimeve të analgjetikëve që kryesisht përmbajnë paracetamol dhe ndonjë nga antireumatikët josteroid. Me shtim të kofeinës dhe të antihistaminëve, apo në formulime të tjera, u përshkruhen përbërës të tjerë të "posaçëm" të reklamuar. Në këtë rast shfrytëzuesit e këtyre barnave janë të hutuar, sepse vërshohen me shumë informata lidhur me preparatin e reklamuar (të dhëna bombastike), ndërsa mund të ketë gjasa që ta blejnë barin që është reklamuar më shumë.

Është me rëndësi kujdesi për këto arsye:

të dihet se bëhet fjalë për barna "seriozë"që patjetër duhet të merren me kujdes;

të pranohet se përdorimi i të gjithë barnave (ata me recetë dhe OTC Barnat) bartin rreziqe të ndryshme, e jo vetëm efekt të dobishëm;

të mësohet sesi merren barnat OTC sipas rregullave, me qëllim që të merren në mënyrë sa më adekuate.

Është e rëndësishme të theksohet se te ne barnat në shitje të lirë reklamohen publikisht duke potencuar se 'Barnat OTC janë më të mirë apo janë krejtësisht të padëmshëm'. Fatkeqësisht përkrah tyre reklamohen edhe barnat me recetë. Barnat me recetë nuk bën të reklamohen, sepse te pacienti mund të shkaktojë përshtypje të gabueshme.

Pasi që barnat në shitje të lirë dedikohen për vetëmjekim, ndihmën kryesore pacientëve gjatë zgjedhjes adekuate të barnave duhet t'ua ofrojnë farmacistët, mjekët dhe infermierët.

Për këtë duhet të kihen parasysh disa të dhëna të rëndësishme:

Të lexohen mirë udhëzimet që bashkëngjiten me barin, të lexohet mirë përbërja e barit, mënyra e përdorimit dhe vërejtjet;

Të përdoret gjithmonë vetëm doza e rekomanduar;

Para kombinimit të terapisë – marrja e barnave të tjerë, të këshillohet me mjekun apo me farmacistin;

Të mbahet evidenca për të gjitha barnat që merren – barnat bimorë, preparatet OTC, preparatet zëvendësuese, barnat me recetë;

Të zgjidhet bari me sa më pak komponentë (në përgjithësi janë preparate më të pranueshme me një përbërës)

L [27]

BARNAT PARALELE –TË NGJASHME

A janë të njëjta Pentrexyl-i, Penbritin-a, Ampicilin-a që përmbajnë substancën e njëjtë mjekuese - ampicilinën

Përparimi me hapa gjigantë në fushën e shkencave mjekësore dhe farmaceutike, në vitet e fundit ka sjellë një vërshim të madh të barnave të reja, duke bërë të mundur përmirësime të ndjeshme në terapinë medikamentoze të sëmundjeve të ndryshme, por njëkohësisht duke krijuar një numër problemesh jo të parëndësishme për praktikën mjekësore dhe farmaceutike. Problemi ndërlikohet më tej në momentin e përshkrimit të një bari të caktuar.

Del pyetja: nëse mjeku duhet ta përshkruajë barin me emrin e tij të përbashkët ndërkombëtar (ose siç quhet ndryshe në mënyrë jo të saktë emër xhenerik) apo me një emër të patentuar. Sa për ilustrim, vetëm në Formularin Kombëtar Britanik (i cili është një botim konciz dhe kritik) paraqiten rreth 20 barna të ndryshëm antiinflamatorë josteroidikë, të ofruar me një numër dy herë më të madh emrash patentë. Megjithëse Organizata Botërore e Shëndetësisë udhëzon që barnat të përshkruhen me emrin e tyre gjenerik (po përdorim këtë term për lehtësi) për shkak të epërsive të një mënyre të tillë përshkrimi, mjaft mjekë i përshkruajnë barnat me emrat e tyre të patentuar-fambrikave(të mbrojtur), gjë që nga ana e saj ka të mirat dhe të metat e veta.

Ky problem shndërrohet në "konflikt" midis mjekut dhe farmacistit në momentin e paraqitjes së pacientit në farmaci dhe dorëzimit të barit nga farmacisti, duke "ngërthyer" në mes tij edhe pacientin.

Në thelb një "konflikt" i tillë nuk duhet të ekzistojë, duke pasur parasysh qëllimin e përbashkët human të këtyre dy shtyllave të kujdesit shëndetësor, mjekësisë dhe farmacisë (pasi të jenë përjashtuar ato motive të interesit material që s'kanë të bëjnë aspak me etikë profesionale).

Pyetja tjetër që shtrohet është: a mund ta zëvendësojë farmacisti barin e përshkruar me një emër të

patentuar me të njëjtin bar të patentuar nga një firmë tjetër prodhuese, apo me një bar gjenerik. Pra, thelbi i dilemës mund të paraqitet në mënyrë thjesht ilustrative: "ZANTAC®, RANITAL® RANISAN® apo ranitidin® "? të cilat përmbajnë si substancë ranitidinën në dozë dhe në formë farmaceutike të njëjtë.

Një çështje e tillë diskutohet edhe në botë.

Që ta themi si ilustrim, edhe ranitali edhe zantacu edhe ranisan kanë substancën e njëjtë mjekuese – ranitidinën (emrin gjenerik – i cili në kutinë e barit është i shënuar me shkronja më të vogla nën emrin e fabrikës-emri i patentuar), dozën e njëjtë, mirëpo kanë disa "dallime" në mes vete: nuk e kanë emrin e fabrikës së njëjtë, nuk e kanë çmimin e njëjtë, ndoshta teknologjia e punimit nuk është e të njëjtit nivel, lëndët ndihmëse mund të jenë të ndryshme për çka edhe i kanë çmimet e ndryshme. Sa i përket kualitetit, gjithmonë duhet të mbështetemi në barnat të cilat shteti në mënyrë ligjore i ka lejuar që të futen në Kosovë, respektivisht kanë pullën e sigurisë - banderolën. Pulla e sigurisë është dëshmia më e sigurt se bari ka kaluar gjithë kontrollin e kualitetit dhe të dokumentacionit, që kërkohen para se një bar të futet në përdorim.

Rreth asaj se a është i njëjtë bari, i cili përmban substancë të njëjtë me emër të patentuar (të fabrikës) të ndryshëm, është i njëjtë me "dallimet" qe i përmendëm më lart.

ÇKA TREGOJNË SHENJAT NË PAKETIMET E BARNAVE

Një numër i konsiderueshëm i barnave në kutitë e tyre mbajnë shenja të veçanta nga barnat tjerë. Këto shenja tregojnë për karakteristikat e këtyre barnave siç janë, ndikimet e tyre në aftësitë psikofizike, drogat dehëse etj. Në grupin e këtyre barnave bëjnë pjesë: Antiepileptikët, antiparkinsonikët, psikoleptikët, psikoanaleptikët etj. Prandaj, të gjithë ata që i marrin këto barna duhet të jenë të vetëdijshëm për karakteristikat e tyre të veçanta, sidomos duhet të kenë kujdes personat të cilët drejtojnë makinat dhe që punojnë në vendet ku kërkohet përqendrim në punë, mundësitë e helmimit me barna të tilla etj. Shenjat e tilla janë:

Δ-Paraqet trigonikët me ndikim të mundshëm në aftësitë psikofizike (Acenosin, Adumbran, Anafranil dra, Bensedin, Bromazepam, Diazepam)

▲ - Paraqet trigonikët me ndikim të fortë në aftësitë psikofizike (Efftil retard, Hexifen, Haloperidol, Karbapin, Tegretol, Largactil, Phenobarbiton etj.

§ - Paraqet barnat të cilët bëjnë pjesë në grupin e drogave dehëse (Artane, Metadon, Thalamonal, Valoron etj.)

† - Barnat me veprim të fortë

††- Barnat me veprim shumë të fortë

☠- Helmet



PËRDORMI I BARNAVE

NË Ç'MËNYRË DUHET T'I PËRDORIM BARNAT DHE ÇKA DUHET PASUR PARASYSH GJATË PËRDORIMIT TË TYRE?

Çdo bar i ka ,,rregullat" e veta për mënyrën e përdorimit të tij, që lidhen me një fakt të thjeshtë: si të veprojë sa më mirë aty ku duhet dhe kur duhet. Këtu mpleksen e ndërthuren shumë pyetje të cilat shpesh i zgjidh mjeku me këshillat e synimet e mjekimit të tij, por më së shumti i zgjidh farmacisti, ky mjek, specialist i mjekimit medikamentoz. Dhe të dy duhet të përpiqen përjetësisht që të rritin njohuritë dhe kulturën shëndetësore të njerëzve, sidomos të të sëmurëve për të rrënjosur disa shprehi të thjeshta në kujtesën e kulturën shëndetësore të gjithsecilit për të bërë të vetëdijshëm e aktivë në zbatimin logjik dhe jomekanik të mënyrave të përdorimit të barnave. Edhe diçka tjetër, një numër gjithnjë e më i madh barnash përdoren në mjekësinë e sotme në disa forma. Kështu p. sh. i njëjti bar mund të përdoret si pomadë, për veprim zakonisht lokal, si tabletë, si shurup, si injeksion apo dhe në ndonjë formë tjetër. Përdorimi i formave të veçanta të të njëjtit bar ka logjikën e vet të paraprirë nga synimi terapeutik mjekues i mjekut.

Më poshtë po ndalemi në shpjegimin e disa mënyrave më të zakonshme të përdorimit të barnave, duke i lidhur këto mënyra pikërisht me synimin terapeutik:

- Në mënyrën e përdorimit të barnave nëpërmjet marrjes së tyre nga goja,
- Si duhen marrë barnat në raport me ushqimin – para, gjatë apo pas ushqimit?
- A duhen marrë barnat gjatë ditës – në mëngjes apo në mbrëmje?

- Me çfarë hapësire kohore duhen marrë barnat dhe
- A duhen dhe si duhen kombinuar barnat me njëri-tjetrin kur është e nevojshme marrja e dy ose më shumë llojeve të barnave?

Si duhet të përdoren barnat nga goja dhe çfarë duhet pasur parasysh?

Dihet se një numër shumë i madh barnash të llojeve e grupeve të ndryshme duhen marrë nga goja. Meqenëse goja nuk është vetëm një portë e thellë për të futur barin në trupin tonë, por një hapësirë, pjesa e parë dhe shumë e rëndësishme e gypit tretës (traktit apo aparatit gastro-intestinal), veçoritë funksionale të mukozës që mbulon hapësirën gojore janë shfrytëzuar shumë bukur dhe në mënyrë të efektshme nga mjekësia e sidomos nga farmacia. Ky "shfrytëzim" i veçorive funksionale të mukozës së gojës ka sugjeruar edhe përgatitjen e një numri të madh barnash.

Të shprehemi më thjeshtë dhe në mënyrë më konkrete e praktike, aq më tepër, sepse sot mjekësia ju ka vënë në dispozicion njerëzve barna me ndikim e veprim të ndryshëm dhe përdorimi i drejtë i barnave nga goja ka rëndësi të madhe për të siguruar efektin e dëshiruar e të pritur dhe për të shmangur efektet negative të tij.

Pikërisht, në varësi nga efekti i pritur e i dëshiruar varet edhe mënyra e përdorimit të barnave, kështu:

Barnat që përdoren për mjekimin e hapësirës gojore dhe të fytit (pra për të vepruar lokalisht), nuk duhet gëlltitur, por duhen mbajtur në gojë për t'u shkrirë gradualisht. Si përfaqësues më të njohur për njerëzit, të kësaj kategorie të barnave për përdorim oral janë antiseptikët dhe antiflogistikët: PANTHENOLI, FITOSEPTI, EKOSEPTI etj. Shkrirja graduale e barit në hapësirën gojore siguron dhe çlirimin gradual të lëndëve vepruese aty ku është "lokalizuar" sëmundja. Gëlltitja e tyre nuk do të jepte efektin e duhur.

- Në praktikën mjekësore janë disa barna, në përdorim shumë të gjerë, madje edhe në urgjencën mjekësore të disa sëmundjeve të përhapura, të cilat veprojnë shpejt, shumë shpejt, duke u thithur prej mukozës së hapësirës gojore e sidomos nga mukoza e nëngjuhës. Të gjithë këtu kujtojnë *Nitroglicerinën*, këtë bar me veprim të shpejtë dhe të mirë në rastet e krizave të dhimbjeve të forta në gjoks – nga patologjitë e enëve të gjakut të zemrës (angina pectorales, vështirësitë në frymëmarrje, infarkti etj.).
- Barnat (tabletat) shkumuese duhet të treten në një gotë ujë, sepse udhëzohet që para përdorimit të shkrihen në një gotë ujë duke përgatitur një tretësirë-limonadë dhe pastaj të pihen. Ato edhe nga pamja janë tableta më të mëdha dhe nuk kapërdihen.
- Barnat (tabletat) të cilat për qëllime të maskimit të erës, shijes dhe të veprimit të tyre (duke i mbrojtur nga pjesë të caktuara të lëngut të traktit digjestiv) duhet të gëlltiten.

Kur duhet të merren barnat: para, gjatë apo pas ushqimit?

Marrja e barnave para, gjatë apo pas ushqimit ka gjithashtu një rëndësi të madhe për të siguruar një efekt sa më të mirë të barit. Duhet të merren para ushqimit, ta zëmë, barnat: AMPICILINA, ATENOLOLI, BIMEPENI, CHYMOCIK-LARI, CEPHALEXINA etj., të cilët në rrethana të tilla është vërtetuar se thithen më mirë. Edhe barnat që përdoren kundër vjelljes, si KLOMETOLI, REGLANI e barna të ngjashëm, mund të veprojnë shumë më mirë kur merren para ushqimit. Gjatë ushqimit, pra, bashkë me ushqimin, duhen marrë barnat si: DAONILI, DIABENESA, etj., të cilët ndikojnë në rregullimin e sheqerit (glukozës), e cila merret me ushqim ose

fitohet nga produktet ushqimore gjatë procesit të metabolizmit të ushqimit. Gjithashtu barnat që luftojnë thartirën (aciditetin e stomakut-kompensai, gelisilacu), e cila krijohet zakonisht pas marrjes së ushqimit. Mirëpo ka edhe barna kundër thartirës që duhet të merren para ushqimit (barnat që pengojnë krijimin e thartirës - veprojnë në H2 receptorë si Omeprazoli etj.). Edhe barnat që kanë njëfarë prirjeje për të dëmtuar mukozën e lukthit, si BRUFENI, ANALGINA, ASPIRINA, DIKLOFENAKU etj., duhet të merren pas ushqimit.

Edhe formimi i disa komplekseve (bashkëdyzimeve) të disa barnave të veçantë me lëndë të caktuara ushqimore, dikton shmangien (evitimin) e përdorimit të atyre lëndëve të caktuara ushqimore, sepse komplekset e sipërpërmendura ndikojnë në mosresorbimin (mosthithjen) e barit.

Kështu në rast se është e nevojshme të merren preparate të tetraciklinës – AMRACIN, CHYMOCIKLAR etj., duhet shmangur përdorimi i qumështit, sepse formimi i komplekseve shpie deri në ndërprerjen e resorbimit të barnave të sipërpërmendura. Ose në rast se duhet përdorur kalciumi dhe preparatet e tij, duhet ditur se kalciumi jep me acidet yndyrore që janë në përbërje të yndyrërave ushqimore, sapune kalçike të patretshme dhe në këto raste kalciumi nuk hyn dot në organizëm, sepse nuk e kapërcen dot "murin" e zorrës. Prandaj këshillohet që preparatet e kalciumit të jepen më mirë larg ushqimit.

Kur duhet të merren disa barna, në mëngjes apo në mbrëmje?

Për disa kategori barnash ka rëndësi të madhe farmakologjike, por edhe biologjike, koha kur duhen marrë: në mëngjes apo në mbrëmje.

Një pjesë e barnave qetësuese dhe për mjekimin e pagjumësisë, si APAURIN, MIANSAN, FLUZEPAM etj., duhet të merren në mbrëmje, sepse atëherë është i dëshiruar

edhe nga ana biologjike efekti i tyre qetësues. Marrja e tyre në mëngjes apo gjatë ditës (me përjashtim të atyre të sëmurëve të cilët duhet t'i marrin këto barna më shumë se një herë) do të çojë në çrregullimin e gjumit.

Grupi i barnave për të nxitur urinimin (diuretikët), si LASIX, ALDOKTON, LOMETAZID, etj. , duhet të merren në mëngjes, jo vetëm pse në rast se merren në mbrëmje a natën nxitin urinimin, por edhe pse në mëngjes efekti i tyre është më i plotë.

Sa duhet të jetë hapësira kohore e përdorimit të barnave?

Për të pasur efektin e dëshiruar barnat, duhet supozuar një përqëndrim i caktuar i secilit bar në gjakun e të sëmurit, pra në organizëm. Për t'a ruajtur atë përqëndrim gjatë gjithë periodës së domosdoshme për mjekim, shkencat mjekësore e farmaceutike kanë caktuar edhe hapësirat (periodat) kohore të dhënies së këtyre barnave. Kjo gjë shënohet edhe në reçetat, por edhe nëse nuk saktësohet aty, atë përcaktim e bën edhe farmacisti. Në udhëzimet e tyre ata shënojnë 2x1, 3x1 apo 4x1 d. m. th. me një "aritmetikë" të thjeshtë shënojnë logjikën e ruajtjes së përqëndrimit farmakologjikisht të efektshëm të kushtëzuar nga intervalet e kohës kur duhet marrë barin brenda 24 orëve.

Kjo ndarje e hapësirës kohore e 24 orëshit, e përllogaritur saktë nga studimet mbi arritjen e përqëndrimeve vepruese të barnave në gjak (d.m.th. në organizëm), merr një rëndësi të veçantë, sidomos, për antibiotikët. Kështu p.sh. është llogaritur që AMOKSICILINA duhet marrë rregullisht në çdo 8 orë (pra tri herë në ditë në hapësira kohore të ndara midis tyre me nga 8 orë), ndërsa AMPICILINA duhet të përdoret në bazë të udhëzimit 4 x 1 pra në çdo 6 orë. Theksojmë hapësirat kohore të marrjes së antibiotikëve sepse ato për të luftuar me sukses kundër mikroorganizmave "agresore" sëmundjeprurëse, kërkojnë përqëndrime të caktura në gjak. Në rast se në gjakun

(pra në organizmin e të sëmurit) do të bjerë niveli i barit (antibiotikut) nën përqëndrimin e kërkuar, atëherë shkaktari i sëmundjes, mikrobi agresor mund të rigjallërohet, të rifillojë veprimtarinë e tij të dëmshme. Por, nuk mjaftohet me kaq, periodat e rigjallërimit të tij e bëjnë atë në shumicën e rasteve më të qëndrueshëm, më rezistent ndaj atij bari (antibiotiku) d. m. th. gradualisht e bëjnë antibiotikun në fjalë pak, ose aspak të efektshëm.

A duhet përdorur dy apo më tepër barna në të njëjtën kohë?

Marrja e shumë barnave pa reçetë, si dhe përdorimi i njëkohëshëm i barnave të dhëna (përshkruara) nga mjeku, ka në shumë raste rreziqe për të sëmurin.

Kështu në qoftë se përdoret ASPIRIN-a në të njëjtën kohë me përdorimin e *Antikoagulantëve* (barnave kundër mpiksjes së gjakut – koagulimit, PELENTAN etj.), atëherë mund të arrihet deri në hemoragji (gjakderdhje) të rënda. Në rast se përdoret ASPIRINA bashkë me INDOMETACINËN që është bar kundër reumatizmit, ASPIRINA ia humb efektin indometacinës.

Vetëm me këta shembuj të këtyre barnave me përdorim të gjerë duhet të bindemi për kujdesin që duhet të kemi, sidomos, në rastet kur duhen përdorur dy ose më shumë barna në të njëjtën kohë. Në këso rastesh të sëmurët duhet të këmbëngulin në njohjen e mirë të udhëzimeve që u jep farmacisti për përdorimin e barnave dhe kombinimin e tyre sepse në këtë mënyrë shmangin veprimet e padëshiruara dhe pasojat e tyre.

BARNAT DHE SHTATZËNIA

A duhet të marrin barna gratë shtatzëna?

Gratë shtatzëna janë një kategori e cila kërkon kujdes më të madh gjatë përdorimit të barnave. Shtatzënat mund të marrin barna vetëm atëherë kur i përshkruan mjeku specialist-gjinekologu, dhe vetëm atëherë kur jeta e shtatzënës është në rrezik, për arsye se pjesa më e madhe e barnave kanë efekte anësore te fryti madje mund të lënë pasoja të rënda, që në shumë raste mund të jenë fatale. Për këto arsye asnjë grua shtatzënë në çfarëdo kohe të shtatzënisë e sidomos në tremujorin e parë të saj nuk duhet të përdorë barna pa u konsultuar me mjekun specialist. Për të pasur parasysh veprimet e tyre negative po japim një pasqyrë të shkurtër të veprimeve të disa barnave në qoftë se përdoren gjatë shtatzënisë. Në rend të parë janë:

Amikacina, Streptomicina dhe Gentamicina të cilat lënë pasoja të rënda në aparatin e dëgjimit, Fenitoina e cila e ngadalëson rritjen, Sulfonamidet siç është rasti me Bactrim-ën që shkakton verdhëz dhe dëmtime në tru, Rifampicina e cila dëmton sistemin nervor qendror, salicilatet si Aspirina, Andoli, që mund të zgjasin kohën e shtatzënisë, e ndërlikojnë atë dhe mund të shkaktojnë gjakderdhje.

Kloramfenikoli i cili dëmton palcën e eshtrave dhe në këtë mënyrë ndryshon cilësinë dhe sasinë e elementeve të gjakut etj.

Këto janë vetëm disa nga shembujt e barnave të cilët mund të veprojnë në mënyrë të dëmshme tek gratë gjatë kohës së shtatzënisë (te fryti).

KUJDESI I NËNAVE

QË I USHQEJNË FËMIJËT ME GJI (ME QUMËSHT) GJATË MARRJES SË BARNAVE

Për foshnjat e gjirit (latantët) dhe fëmijët deri në moshën një vjeçare (infantët) ushqimi më i shëndoshë dhe më i pasur me lëndë ushqimore, vitamina e minerale, si dhe më i përvetësueshëm (asimilueshëm) prej fëmijës, është qumështi i nënës, pra – ushqimi me gji.

Që qumështi i nënës të ketë gjithmonë vlera të larta ushqimore, për të mirërritur një fëmijë trupërisht (fizikisht) dhe mendërisht (psikikisht), është i domosdoshëm kujdesi i nënës që e ushqen me gji foshnjen e vet, para së gjithash për ushqimin e saj. Pra nëna gjatë ushqyerjes duhet të ketë parasysh jo vetëm kërkesat energjetike të saj, por njëkohësisht edhe të foshnjes (latantit), e cila gjirin e ka burim të vetëm të ushqimit natyror.

Kjo do të thotë që ushqimi i nënës me fëmijën në gji duhet të jetë i pasur me lëndë proteinike lehtësisht të përvetësueshme prej organizmit, lëndë yndyrore dhe sheqerore si dhe me vitamina të tretshme në ujë (hidrosolubile ku hyjnë vitamina C dhe kompleksi vitaminik i quajtur kompleski B-vitaminik me vitaminat B1, B2, B6, etj.), vitamina të tretshme në yndyrëra (liposolubile ku hyjnë vitaminat A, D, E, K, F) si dhe me lëndë minerale: makroelemente ku hyjnë në radhë të parë elementet e domosdoshme për formimin e një skeleti normal të foshnjes në rritje e sipër si dhe me mikro apo oligoelemente aq të domosdoshme për zhvillimin normal të të gjitha organeve e sistemeve të organizmit. Në qoftë se këta përbërës ushqimorë nëna i siguron në sasi dhe raporte normale midis tyre, atëherë kjo nënë do t'ja përcjellë ato me bujari të madhe foshnjes së vet nëpërmjet qumështit të gjirit. Gjëndrat e qumështit e prodhojnë dhe e sekretojnë qumështin me të gjitha "të mirat" e përmendura më sipër dhe foshnja mjafton të thithë me

kënaqësinë e natyrshme për të siguruar një ushqim të përshtatshëm nga ana cilësore dhe sasiore.

I përmendëm të gjitha (si më sipër) për të theksuar pikërisht bujarinë dhe gatishmërinë e organizmit të nënës me fëmijën në gji, që kërkesat e domosdoshme energjetike për rritjen e një fëmije normal dhe të shëndoshë t'i plotësojë përmes gjëndrave të qumështit dhe natyrisht prodhimit të tyre - qumështit (ushqimit të tij të parë dhe të vetëm, por edhe më të shijshmit në botë).

Gjatë ushqyerjes me gji duhet pasur parasysh edhe anën tjetër. Barnat që mund t'i marrë nëna gjatë periudhës së ushqimit të fëmijës me gji, mund të kalojnë në shumicën e rasteve me anë të qumështit edhe tek fëmija. Këto barna mund të:

- Pengojnë ose nxisin prodhimin e qumështit.
- Ndryshojnë përbërjen e qumështit.
- Kalojnë në qumësht dhe japin veprime të dëmshme ose helmuese për latantin, duke e dëmtuar atë në shkallë të ndryshme. Sigurisht, efekti (veprimi) toksik i barnave tek latanti (fëmija në gji) do të jetë aq më i madh dhe më i rrezikshëm sa më e madhe të jetë doza (sasia) e barit të marrë prej nënës.

Efekti toksik (helmues) i barnave tek fëmija që pi gji (latanti) varet edhe nga vetitë farmakologjike të barit, sespe ka raste kur edhe sasi të vogla të barit mund të dëmtojnë rëndë fëmijën.

Për këto arsye kur nëna me fëmijë në gji, është e detyruar për shkak të sëmundjeve të ndryshme të mjekohet, duhet të këshillohet paraprakisht me mjekun dhe farmacistin për të shmangur apo zvogëluar në maksimum veprimet e dëmshme të barnave mbi fëmijën e vet.

Atëherë, sa herë që i kështillohet dhënia e një bari, nënës që ushqen me gji fëmijën e vet, duhet të merren në konsideratë këto të dhëna:

- A është në të vërtetë e domosdoshme dhënia e barit?
- Të jepet ai bar për të cilin jemi të sigurtë.
- Të merret bari në atë pjesë të ditës që është më pak i kalueshëm tek fëmija: p. sh. nëna e merr barin, pasi i ka dhënë për të pirë fëmijës ose/dhe në kohën që fëmija fle më gjatë, pra sa më larg kohës së afatit tjetër. Kështu bari jashtëqitet me rrugë tjera (djersë, urinë, tëmth) dhe jo me anë të qumështit. Kështu evitohet mundësia e pranisë së barit në sasi të madhe në qumështin e gjirit.
- Nëse dhënia e barit është e domosdoshme për nënën, atëherë duhet të parashikohet edhe ndërprerja e (ushqyerjes me) gjirit përkohësisht dhe/ose përfundimisht, të kontrollohet sasia e barit në gjakun e fëmijës.

Nëna duhet të dijë se cilat barna nuk duhet përdorur gjatë periudhës së ushqimit me gji (periudha e laktacionit), aq më tepër kur përdor barna pa u këshilluar me mjekun, fatkeqësisht shumë nëna me fëmijë në gji, përdorin barna pa u vizituar dhe këshilluar me mjekun e farmacistin.

Në bazë të dëmit që mund të shkaktojnë barnat në organizmin e fëmijës, ndahen në 3 kategori:

- *Barnat për të cilat është vërtetuar ose supozohet se mund të dëmtojnë fëmijën që ushqehet me gji.*
- *Barnat për të cilat nuk jemi të sigurtë për dëmin që mund të shkaktojnë, prandaj duhet dhënë me shumë kujdes (më mirë të shmangen) dhe*
- *Barnat që mund të jepen pa frikë, sepse nuk kalojnë në qumësht ose dihet që nuk e dëmtojnë fëmijën.*

BARNAT E SIGURTA GJATË USHQYERJES ME GJI

1. Acidi folik (FOLAN)
2. Adrenalina
3. Antibiotikët (PENICILINA, AMPICILINA,AMOKSICILINA,
4. CEFALOSPORINAT, AMINOGLIKOZIDET)
5. Antihipertensivët (CAPTOPRIL, ENALAPRIL,ADALAT,ALDOMET)
6. Atropina
7. Betabllokuesit(PROPRANOLOL, INDERAL)
8. Digoksine(LANICOR, DILACOR)
9. Hekuri (FEROHEL)
10. Heparina
11. Hormonet e tireoides (në doza të vogla)
12. Insulina
13. Karbamazepina (MAZEPIN, TEGRETOL)
14. Klorokina
15. Kodeina
16. Kripërat e arit
17. Laksativët me laktulozë, vaji i parafinës, vazelina
18. Paracetamoli(PANADON, FEBRICET)
19. Prednizoni (PRONISON)
20. Propiltiouracili
21. Sulfati i bariumit
22. Zovirax

BARNAT QË DUHET TË PËRDOREN ME KUJDES GJATË USHQYERJES ME GJI

1. Antiepileptikët (BARBITURATET)
2. Antikoagulantët oral (SINTROM)
3. Antipsikotikët
4. Antituberkularët
5. Antiulcerozët
6. Atenololi
7. Bactrim
8. Benzodiazepinat (DIAZEPAMI)
9. Cinarizina
10. Deksametazoni,Betametazoni
11. Desferali

1. Diuretikët (LASIX)
2. Eritromycin
3. Kloramfenikoli
4. Laksativët me bazë cascara sagradae, sene, vaj ricini
5. Metronidazoli
6. Negram, Nitrofurantoin (BACTOGRAM)
7. Prometazina (PHENERGAN)

BARNAT TË CILAT NUK DUHET TË PËRDOREN GJATË USHQYERJES ME GJI

Amiodaron, Cordaron
Androgenet
Antidepresivet frenues të MAO
Antitiroidienet
Bromocriptina (BROMERGAN)
Ciprofloxacina (CIPROCINAL)
Citostatikët
Drogat (heroina, morfina, kokaina, amfetamina)
Ergotamina
Indometacina (INDOCID)
Lëndët që përdoren në radiologji
Litiumi

Po i japim disa shembuj të veprimit të dëmshëm të barnave, nga praktika e përditshme dhe të vërtetuara shkencërisht:

Bromokriptina frenon prodhimin e qumështit.

Ergotamina përdoret te dhimbja e kokës. Mund të shkaktojë barkqitje, vjellje, dhe çrregullime të gjakut tek fëmija, pra ka veprim toksik. Në doza të mëdha mund të frenojë laktacionin.

Kontraceptivët (barnat kundër shtatzënisë) – estrogjenët kanë veprim të dëmshëm në laktacion.

Barnat qetësuese si benzodiazepinikët – janë të pranishëm në qumësht dhe shkaktojnë gjendje letargjike (përgjumësi) te fëmijët.

Laksativet – barna që përdoren për të dalë jashtë si gjethet e Senës, përdoren mjaft shpesh nga lehonat për të luftuar kapsllëkun. Një pjesë e barnave mund të thithet nga fëmija duke përshpejtuar lëvizshmërinë e zorrëve të fëmijës duke shkaktuar diare tek ai.

Aspirina, Andoli – duhet shmangur, sepse mund të shkaktojnë sindromin Rey tek fëmijët që kanë pamjaftueshmëri të vitaminës K, çrregullime në funksionin e

trombociteve (qelizave të gjakut që kanë detyrë të ruajnë tërësinë e enëve të gjakut në raste dëmtimesh nëpërmjet dukurisë së mpiksjes -koagulimit të gjakut) dhe hypoprotrombinemi (rënie të nivelit të protrombinës në gjakun e fëmijës).

Antibiotikët mund të ndikojnë gjithashtu tek latanti (fëmija i gjirit).

Tetraciklinat fundërrojnë në eshtrat e fëmijës në formë të kompleksеve me kalcium, të cilët natyrisht nuk janë të njëjta me funksionet kockëformuese të tyre. Ndryshimi i procesit të kockëformimit dëmton sistemin kockor të fëmijës në rritje, dhe mund të çojë deri në deformime. Edhe dhëmbët që mund të kenë dalë ndryshojnë ngjyrën në të verdhë të mbyllur.

Kloramfenikoli mund të shkaktojë suprimim të palcës kockore të fëmijës, përqendrimet në qumësht janë të pamjaftueshme për të shkaktuar sindromin e "bebit gri".

Ciprofloksacinat duhet shmangur, sepse arrihen përqendrime të larta në qumësht.

Baktrima mund të shkaktojë dëmtimin e trurit (kern ikterus) te fëmijët ikterikë dhe hemolizë (shkatërrim të eritrociteve) te fëmijët me mungesë të G6PDH (glukoze 6 fosfat dehidrogjenaza).

Ka dhe shumë barna të tjera për të cilat nuk ka të dhëna të mjaftueshme për efektet e dëmshme dhe shkallën e dëmtimit të fëmijës gjatë përdorimit prej nënës në periudhën e laktacionit. Si përfundim, çdo nënë që ushqen fëmijën me gji duhet të ketë parasysh se:

- Pothuajse të gjitha barnat e marra nga nëna kalojnë në qumësht.
- Ato vërtet gjenden në sasi të vogël (më pak se 1-2 % e sasisë që merr nëna) dhe mund të mos veprojnë tek fëmija.
- Sidoqoftë, marrja e tyre duhet të kufizohet dhe të bëhet vetëm pas këshillimit me mjekun dhe farmacistin.

BARNAT DHE FËMIJËT

Përdorimi i barnave te fëmijët

Ndryshimet cilësore fiziologjike ndërmjet fëmijëve dhe të rriturve e bëjnë të domosdoshme njohjen e disa parametrave bazë në përdorimin e barnave, kryesisht farmakokinetikën dhe farmakodinamikën e barnave në moshën fëmijërore.

Farmakokinetika përfshin vlerësimin sasior të barnave d. m. th. përthithjen, shpërndarjen, ndryshimet që mund të pësojë bari në organizëm dhe eliminimin. Farmakodinamika përfshin efektet biokimike dhe fiziologjike të barnave, pra mekanizmin e veprimit.

Duhet pasur kujdes sidomos gjatë përdorimit të barnave në periudhën neonatale (28 ditët e para të jetës), së pari, shkëmbimi i lëndëve apo metabolizmi i të porsalindurit akoma nuk është i plotë, sidomos nga ana sasiore, me sistemet enzimatike dhe, për rrjedhojë një "deficit relativ" i tillë i enzimave do të ndikojë edhe në "metabolizmin" e vetë barit. Kjo "papjekuri relative" e metabolizmit, përfshin edhe metabolizmin e barit të dhënë, mund të ndikojë në ndryshimin e efekteve apo të ndikimit të tij mbi organizmin e të porsalindurit.

Së dyti, prania e një papjekurie relative të veshkave (dhe funksioneve të tyre) në të porsalindurit (d. m. th. në 28 ditët e para të jetës), mund të kufizojë eliminimin e barnave nga trupi i foshnjes, mund të qëndrojë dhe të veprojë më gjatë, dhe për rrjedhojë të theksojë toksicitetin. Në të porsalindurit klirensi i veshkave (aftësia pastruese e tyre) është më e ulët.

Për këto arsye në të porsalindurit nuk mund të përdoren doza të njëjta të barnave (të llogaritura për kilogramë/peshë) si tek periudhat e tjera të moshës fëmijërore. Ato duhet të jenë më të ulëta dhe të jepen në intervale kohore më të gjata.

KUJDES GJATË PËRDORIMIT TË BARNAVE TE FËMIJËT

Fëmijët përbëjnë kategorinë më të brishtë të popullsisë, e cila ka shumë nevojë të përdorë barna. Natyrisht këto barna ju përshkruajnë mjekët në recetat e tyre, më rrallë ua japin farmacistët (kur ju kërkohen dhe mbi bazën e indikacioneve të caktuara). Jo rrallë fëmijëve ju jepen barna edhe nga vetë familjarët e tyre pa i kontrolluar (vizituar) paraprakisht tek mjeku ose kur, për momentin, familjarët nuk kanë mundësi që të konsultohen me mjekun.

Për vetë veçoritë e moshës foshnjërore e fëmijërore farmaceutika e sotme bashkëkohore ka prodhuar forma barnash, të cilat pranohen lehtësisht (madje edhe me një farë kënaqësie prej fëmijëve). Këto forma të barnave janë përgatitur në atë mënyrë që të mos ndikojnë aspak në veprimin e tyre farmakologjik, por të modifikojnë shijen dhe erën e barnave për t'i bërë ato të pranueshme dhe të këndshme për fëmijët. Në forma të tilla ato merren lehtë prej fëmijëve. Një pjesë e madhe e tyre përgatiten në forma të lëngshme si shurupe apo tretësira dhe ju jepen fëmijëve të sëmurë me doza që mund të përllogariten lehtë prej prindërve. Dhe pikërisht tek ky dozim fillon edhe vështirësia dhe këtu duhet përqendruar edhe vëmendja.

Përse?

Shumë prej shurupeve apo tretësirave kanë edhe "lugën" e vet apo pikatoren dhe në këto raste shkalla e vështirësisë së dozimit të barit tek fëmija është e pakët. Mirëpo ka edhe shumë shurupe apo tretësira që nuk i kanë këto mjete të thjeshta matëse. Në udhëzimet përkatëse që shoqërojnë çdo bar jepet edhe udhëzimi përkatës për përdorimin e tyre. Në shumë raste nëpër udhëzime thuhet se dozimi duhet bërë me lugë kafeje. Është llogaritur që një lugë e zakonshme kafeje të

marrë 5 ml lëng, por në praktikën e përditshme ka disa lloj lugësh kafeje që mund të marrin nga 3 ml deri në 7 ml lëng.

Në rast se një familjar do të përdorë një lugë "të madhe" kafeje prej 7 ml do të paraqitet rreziku i marrjes së dozave më të mëdha (mbidozimi) se sa nevoja për mjekimin e fëmijëve të sëmurë, me të gjitha pasojat e mundshme.

Në rast se një familjar do të përdorë një lugë "të vogël" kafeje prej 3 ml, fëmija i sëmurë do të përballet me dy rreziqe të mundshme, së pari do të marrë një dozim të pamjaftueshëm (nëndozim), dhe kjo do të ketë si pasojë mosmposhtjen e sëmundjes, zgjatjen apo rëndimin e mundshëm të saj d. m. th. mosefektivitetin e barit të përdorur dhe së dyti, mikroorganizmat agresorë që kanë kushtëzuar sëmundjen e fëmijës, duke mos u luftuar sa e si duhet, dalin fitues ne këtë luftë të pabarabartë, duke u bërë rezistentë ndaj barit të përdorur, sidomos kur është fjala për antibiotikë.

Një problem tjetër që ka të bëjë gjithashtu me dozimin e saktë të barnave është edhe ai i përgatitjes së shumë shurupeve në shtëpi, pasi janë marrë nga farmacia në formë pluhuri. Dhënia e atyre barnave me formë pluhuri bëhet për të ruajtur sa më gjatë efektivitetin e veprimit të tyre – aq sa është edhe data e skadimit të çdo bari. Por, po këto barna pas tretjes dhe shndërrimit të tyre në shurupe, bëhen të paqëndrueshme dhe duhet përdor maksimumi brenda javës.

Zakonisht tretja e pluhurave për t'u shndërruar në shurupe për fëmijë bëhet me ujë të destiluar që i jipet familjarit bashkë me pluhurin. Por shpesh, dhënia e tretësit (ujit të destiluar) bëhet pa matje vëllimi dhe ka rrezik që suspensioni i shurupit të përgatitur mos t'i ketë raportet e caktuara – pluhur /tretës , e cila shpie në mosmarrjen e dozave të caktuara.

Pra, në qoftë se në shikim të parë këto duken si probleme të thjeshta, ato kërkojnë rigorozitet e saktësi në procedurën e përgatitjes dhe të dozimit (pra të dhënies tek fëmija i sëmurë) dhe këtu barra kryesore për shmangien e mangësive dhe të pasojave të dëmshme të tyre i takon farmacistit.

Udhëzimi për përdorim – Është kërkesë kryesore ndaj farmacistit sqarimi i udhëzimit për mënyrën e përdorimit të barnave, i cili vetëm me disa veprime të thjeshta shmang pasaktësitë dhe gabimet. Konkretisht, në qoftë se tek ne lugët e kafesë janë nga 3-7 ml, është e udhës që çdo farmaci të ketë një lugë që merr 5 ml, të cilën duhet t'ia tregojë familjarit që i merr barnat për fëmijën e vet. Një orientim i tillë i thjeshtë mundëson dozimin e saktë të barit që duhet të marrë fëmija i sëmurë. Të njëjtën gjë, duhet ta bëjë farmacisti duke e këshilluar familjarin që i merr barnat për sasinë e ujit të destiluar në të cilin duhet të tretet pluhuri i barit. Në shumicën e rasteve tretja e shurupeve bëhet në barnatore me matësen e vëllimit, që nuk është gjë tjetër veçse një enë e shkallëzuar. Ka edhe shumë njerëz që këmbëngulin ta marrin barin në formë të pluhurit për t'a përgaditur vetë në shtëpi suspensionin e shurupit. Kjo bart një rrezik: nuk janë të rralla rastet kur familjarët nuk ia japin të gjithë shurupin fëmijës së sëmurë (të ndarë në dozat përkatëse), por ia japin një pjesë të tij dhe pjesën e mbetur të suspensionit shurup e ruajnë për ndonjë rast tjetër kur të sëmuret përsëri fëmija apo, ndonjë fëmijë tjetër. Kjo bart një sërë rreziqesh prej të cilëve po i përmendim dy më kryesorët:

- Së pari, shurupi i përgatitur nuk ka më të njëjtin afat skadimi si e ka pluhuri para tretjes. Efektet mjekuese të shurupit ekzistojnë vetëm për pak ditë – aq ditë sa është llogaritur "konsumimi" i tij me dozat e caktuara.

- Së dyti, pluhurat dhe shurupet e përtaditura nga tretja e tyre, janë llogaritur në sasi që të jenë plotësisht të mjaftueshme vetëm për një kurë mjekimi. Në rast se shurupi i përgatitur nuk do të përdoret i gjithë kjo do të thotë që do të ndërpritet në mes kura (mjekimi) me të

gjitha pasojat e mosmarrjes së dozës së përgjithshme të plotë. Dhe ende më keq ripërdorimi i një shurupi të përgatitur kohë më parë është i paefektshëm, sepse në kushtet e tretësirës shkurtohet shumë afati i skadimit të barit.

Vërejtje: Barnat për fëmijë nuk duhet të përzihen me ushqim (çaj, qumësht etj.) për arsye të thjeshtë, se në shumicën e rasteve fëmija i sëmurë nuk e merr dot ushqimin e tërë, çka do të thotë se nuk e merr as dozën e barit të caktuar.

Së fundi, do të theksojmë diçka që e kemi vënë re në praktikën tonë të përditshme: *përdorimin e barnave pa e vizituar fëmijën e sëmurë tek mjeku, siç janë barnat që përdoren kundër temperaturës, kollës, diaresë dhe disa antibiotikë.* Gjithsesi, çfarëdo qofshin rrethanat e një veprimi të tillë, duhet që në një kohë sa më të shpejtë gjithsesi fëmija të vizitohet tek mjeku, sepse edhe prapa simptomeve të sipërpërmendura, mund të fshihen sëmundjet më të rënda. Përdorimi i antibiotikëve pa u konsultuar me mjekun është me pasoja edhe më të rënda. Antibiotikët duhen të përdoren vetëm nëse për përdorimin e tyre i udhëzon mjeku, sepse në të kundërtën marrja e antibiotikut kur ai nuk është i nevojshëm rëndon edhe më shumë gjendjen e fëmijës së sëmurë, mund të krijohen rezistenca mikrobike ndaj antibiotikëve të përdorur pa kritere, që në të shumtën e rasteve janë të dëmshme dhe me pasoja të paparashikuara.

BARNAT DHE TË MOSHUARIT

Si duhet t'i përdorin barnat njerëzit e moshuar?

Mosha mbi 65 vjet – shpesh quhet mosha e tretë ose periudha e pleqërisë. Gjenerata e moshës së tretë është e prekshme nga një sërë sëmundjesh, kryesisht kronike e degjenerative si: sëmundjet reumatike, sëmundja e sheqerit, shtypja e lartë e gjakut, arteriosklerozа me të gjitha pasojat e ndërlikimet e saj të zemrës dhe trurit, anemitë etj. Është problematike te kjo moshë shfaqja në të njëjtën kohë e dy apo më shumë sëmundjeve dhe kjo bëhet si shkak që të moshuarit nuk paraqiten për kontroll mjekësor. Përdorimi i detyruar i shumë llojeve të barnave kërkon që këta të sëmurë të jenë të kujdesshëm gjatë marrjes së tyre , sepse përpos veprimeve individuale anësore mund të ketë pasoja serioze e të rënda edhe reagimi i njërit bar me barin tjetër (ndërveprimi), që mund të çojë në ndërlikime të rënda. Problemin e rëndon më shumë edhe fakti se tek të moshuarit shumë funksione organike ndryshohen, kryesisht dobësohen, prandaj është shumë e rëndësishme që të kihen parasysh të gjitha këto rrethana, sidomos për dozimin e barnave.

Nga sa thamë del se të sëmurët e moshuar patjetër duhet të bashkëpunojnë me mjekun e farmacistin rreth mënyrës së përdorimit të barnave, në mënyrë që të shmangen sa të jetë e mundur më shumë dëmet e mundshme që mund të sjellë përdorimi i barnave të shumëllojshme në këtë moshë dhe të arrihet një përshtatshmëri sa më e mirë lidhur me dozat për njerëz të moshuar. Këtu në radhë të parë duhet të jenë barnat me ndikim të rrezikshëm në këtë moshë p. sh. barnat me veprim frenues, qetësues siç janë ato kundër pagjumësisë, paqëndrueshmërisë emocionale etj. Dozimi i këtyre barnave duhet të bëhet me kujdes për arsye se eliminimi i tyre nga

organizmi është 2-3 herë më i ngadalshëm se sa te personat e rritur dhe me organe të ruajtura fiziologjikisht. Si shembull përmendim *fenobarbitonin,* i cili zakonisht eliminohet nga organizmi për 8 orë, por që te personat e moshuar mbahet edhe për 2-3 herë më gjatë.

Antihipertensivët (barnat kundër shtypjes së lartë të gjakut) gjithashtu duhet të jepen me doza të kontrolluara për arsye se këto barna zvogëlojnë qarkullimin e gjakut nëpër organe vitale e sidomos në tru dhe zemër ku pasojnë pastaj ndryshime të shumta.

Diuretikët (barnat për urinim) gjatë veprimit të tyre nga organizmi nëpërmjet veshkave përpos lëngjeve (ujit) largojnë edhe kripërat. Humbja e ujit dhe elektrolitëve mund të dobësojë më shumë organizmin dhe përsëri mund të çojë në ndërlikime të tjera në organizëm.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për barnat kundër dobësimit të zemrës.

Në mënyrë që të shmangen shumë fatkeqësi, të sëmurëve duhet t'u jepet një numër mundësisht sa më i pakët i barnave dhe atë në doza të cilat janë të mjaftueshme.

Nuk mund të rrimë pa përmendur edhe disa probleme që në përgjithësi i kanë të sëmurët e moshuar siç është problemi ekonomik. Shumë të moshuar nuk kanë mundësi që të kontrollohen rregullisht te mjeku dhe për më tepër nuk kanë mundësi për të blerë barnat që ju duhen e për të cilat kanë nevojë. Ka shumë raste që të moshuarit që ndodhen në rrethana të tilla, përdorin barna që kanë mbetur pa u përdorur, dhe të ruajtura në kushte të papërshtatshme. Po aq e rëndësishme është edhe mospërdorimi i rregulltë i barnave për shkak të harresës (si kohë-marrje dhe si dozë).

NDËRVEPRIMET (PAPAJTUESHMËRITË) E BARNAVE

Mjekimi i vetevetes (vetëmjekimi) apo i ndonjë pjesëtari të familjes me barna, të cilat mund të merren edhe pa reçetë kërkon disa njohuri paraprake për barnat që do të përdoren. I sëmuri që vetëmjekohet, pra që guxon të luajë edhe rolin e mjekut edhe atë të farmacistit edhe pse mund të jetë i sigurtë për njohuritë që ka marrë për barnat që do të përdorë, duhet të ketë parasysh dhe të mos harrojë edhe një fakt të rëndësishëm. Ai mund të jetë në një vazhdim normal mjekimi, me kurat e dhëna nga mjeku dhe problemet që lidhen me barnat që merr "tradicionalisht" i njeh dhe madje mund t'i ketë përforcuar edhe plotësuar në vazhdimësinë e mjekimit të vet. Por i sëmuri, apo familjari që përdor tek fëmija apo ndonjë pjesëtar tjetër i familjes barnat e marra pa reçetë ose në rast se mendon të shtojë në mjekimin e zgjatur, tradicional, ndonjë bar tjetër, gjithmonë të marrë pa reçetë, duhet të ketë parasysh edhe ndërveprimin e barnave midis tyre.

Ky ndërveprim përgjithësisht mund të jetë *sinergjist* d. m. th. ndikon për të fuqizuar e rritur ndërveprimin, interaksionin e barnave, por mund të jetë edhe *antagonist,* i kundërt d. m. th. që ndikon në zvogëlimin e veprimit të barnave. Ky ndërveprim mund të përfshijë madje edhe toksicitetin (helmueshmërinë) e barnave, mund t'i sjellë të sëmurit probleme të rënda. Ato, jo rrallë mund të jenë vdekjeprurëse, fatale.

Prandaj është e logjikshme apo siç shprehet shumë bukur populli ynë, është e udhës që çdo njeri, i cili merr barnat e dhëna nga mjeku dhe barna të tjera, duhet të njohë ndërveprimin e mundshëm midis barnave "të rregullta" të dhëna nga mjeku, me barnat që i sëmuri vendos t'i përdorë pa u këshilluar me mjekun.

Për të lehtësuar sadopak këtë problem ne po i paraqesim ndërveprimet e disa barnave që merren pa reçetë, por që edhe janë më të përdorurit në praktikën e sotme mjekësore.

Analgjetikët

Më të përdorurit janë ASPIRINA, INDOMETACINA, BUTAZOLIDINA e kombinimet e tyre) të cilat mund të ndërveprojnë me:

- *barnat kundër koagulimit (mpiksjes) të gjakut (*PELENTAN*).* Ky ndërveprim fuqizon veprimin e barnave kundër koagulimit të gjakut (antikoagulantët) aq sa mund të shkaktojnë gjakderdhje (hemoragji) me pasoja të rënda. Gjakderdhjet e tilla janë më të shpeshta sidomos tek njerëzit që vuajnë nga i thati i lukthit (ulcera e stomakut). Analgjetikët mund të ndërveprojnë me antikoagulantët jo vetëm tek njerëzit me ulcerë të lukthit por ata mund të shkaktojnë (si rezultat i fuqizimit të veprimit të antikoagulantëve) edhe ulcerë të lukthit, e cila që në fillimet e saj të shfaqet me gjakderdhje.
- Analgjetikët ndërveprojnë me ALKOOLIN, prandaj gjatë marrjes së tyre nuk duhet të përdoren birra dhe pijet alkoolike, sepse ato shkaktojnë ngacmime të lukthit dhe gjakderdhje të rrezikshme
- Analgjetikët ndërveprojnë me *barna që përdoren për mjekimin e sëmundjes së sheqerit (antidiabetikët)* si DIABENESIN, DAONILIN, EUGLUKONIN etj. , duke i fuqizuar antidiabetikët në veprimin e tyre për uljen e nivelit të sheqerit në gjak. Për rrjedhojë ndërveprimi analgjetikë – antidiabetikë mund të çojë në një rënie të shpejtë të nivelit të sheqerit edhe nën nivelin normal të tij (hypoglicemi të shpejtë).
- Aspirina ndërvepron me *barna kundër reumatizmës*-INDOMETACINA duke pamundësuar veprimin e tyre,
- në rast se analgjezikët do të përdoren së bashku me *barnat kundër shtypjes së lartë të gjakut (antihipertenzivët) si* IZOBURINA etj. , për shkak të ndërveprimit të tyre, bëhet i pamundur një mjekim i suksesshëm i hipertensionit (shtypjes së lartë të gjakut).

Kontraceptivët

Barnat që përdoren kundër shtatzënisë (si EUGYNONI, NEOGYNONI, STEDIRILI etj.), ndërveprojnë me:

- Barna të tilla, si: BARBITURATET, FENITOINËT, ANTIHISTAMINIKËT, RIFAMPICINËN etj. , dhe që mund të konsiderohen si barna që përshpejtojnë metabolizmin e një sërë barnash në mëlçi. Nga ky ndërveprim zvogëlohet shumë veprimi, efekti i kontraceptivëve aq sa, megjithë përdorimin e tyre të rregullt, duke e pasur veprimin e tyre të frenuar e të zvogëluar, mund të çojnë deri në një shtatzëni të padëshiruar.
- *Antikoagulantët*, (PELENTAN) duke e zvogëluar veprimin dhe efektin e këtyre të fundit dhe kjo shpjegohet me faktin e rritjes së prodhimit të faktorëve të koagulimit nën ndikimin e kontraceptivëve.
- Në rast se kontraceptivët oralë (që merren nga goja) do të përdoren nga gratë që pinë DUHAN, atëherë kjo mund të çojë deri në shfaqjen e trombozës së venave.

Antidiabetikët oralë

Barnat që përdoren për mjekimin e sëmundjes së sheqerit (diabetit) si: DIABENESE, DAONILI etj. , ndërveprojnë me:

- *Kontraceptivët* (si EUGYNONI, NEOGYNONI, STEDIRILI etj.) dhe nga ky ndërveprim zvogëlohet efekti i antidiabetikëve. Kjo imponon një kontroll më të shpeshtë të glicemisë (nivelit të sheqerit në gjak) për të "korrigjuar" dozat e antidiabetikëve.
- *Antikoagulantët (*PELENTAN, SYNCUMAR etj.) dhe si rezultat i kësaj kemi rënien e sheqerit në gjak (hipoglicemisë) dhe humbjen e vetëdijes, dhe në anën tjetër antidiabetikët rrisin veprimin e antikoagulanteve çka mund të çojë deri te gjakderdhjet e brendshme.
- ALKOOLIN (PIJET ALKOOLIKE), ANTIHISTA-MINIKËT, KONTRACEPTIVËT, KLORPROMAZINËN, DIURETIKËT, HORMONET E TIROIDËS, etj. , të cilat e zvogëlojnë efektin e antidiabetikëve oralë.

- ASPIRINËN DHE KOMBINIMET E SAJ, FENILBUTA-ZONIN, KLORAMFENIKOLIN, TETRACIKLINËN, SULFONAMIDET të cilat e fuqizojnë veprimin e antidiabetikëve oralë.

Barnat kundër pagjumësisë dhe ngarkesës psikike

Barnat që përdoren kundër pagjumësisë dhe ngarkesës psikike, si**:** APAURINA, ANSILANI, CERSONI, MOGADONI etj. , reagojnë (ndërveprojnë) me:

- *Pijet alkoolike (birrë, verë, raki)* , ndërveprim ky i cili mund të shpie deri në një depresion të shprehur të shoqëruar edhe me zvogëlimin e mundësisë së koordinimit të lëvizjeve.

Antidepresivët treciklikë

Antidepresivët treciklikë si: ANAFRANILA, SINEQUANI, TRYPTAZOLI reagojnë me:

- *Alkoolin dhe pijet që përmbajnë alkool* duke shkaktuar depresion dhe ulje të temperaturës trupore
- *Antikoagulantët (*PELENTAN, SYNCUMAR *etj*.), si pasojë rritet efekti i antikoagulantëve, çka mund të çojë në gjakderdhje të brendshme.
- *Barnat kundër epilepsisë* HYDANPHEN, DIFETOIN me çka zvogëlohet efekti i barnave kundër epilepsisë
- *Antihipertenzivët (*ALDOMET, METILDOPA, BRINERDIN etj.) dhe pamundësohet kontrollimi i shtypjes së gjakut.
- *Benzodiazepinat* (ADUMBRAN, APAURIN, LIBRIUM etj.) duke e potencuar veprimin e benzodiazepineve në tru me çka krijohet një rezik potencial sidomos për drejtuesit, ngarësit e makinave dhe atyre që punojnë në vendet e punës ku kërkohet përqendrim i vëmendjes.

Barnat kundër reumës (Artritit)

Barnat kundër reumës (Artritit), si: INDOMETACINË, BUTAZOLIDINË, PHENIBUTAZON etj. , reagojnë me:

- *antikoagulantët* duke e rritur veprimin e tyre.
- *aspirinën* dhe preparate që përmbajnë aspirinë duke shkaktuar dhimbje barku dhe të thatin në lukth. Gjithashtu këto barna zvogëlojnë veprimin e antireumatikëve.
- *kontraceptivët* duke e zvogëluar efektin e kontraceptivëve dhe duke e rritur mundësinë e mbetjes shtatzënë.
- *antidiabetikët* duke e rritur efektin e tyre.

Diuretikët me veprim të lehtë

Barnat për urinim: TIARENI, MODURETIKU etj. , ndërveprojnë me:

- *antihipertenzivët si* ALDOMET, METILDOPA, SINEPRES etj. (që në të shumtën e rasteve mjekët e përshkruajnë për të fuqizuar veprimin, shkakton ulje të shpejtë dhe të theksuar të shtypjes së gjakut, kështu që nevojitet kontrollimi më i shpeshtë i shtypjes së gjakut.
- *antidiabetik si* DIABENESE, DAONIL etj. , duke e pamundësuar mbajtjen nën kontroll të nivelit të sheqerit në gjak (glicemia bëhet e paqëndrueshme)
- *barnat kardiotonike si* LANICOR, DIGITOKSINA, DILACORI etj. , duke prishur ekuilibrin e elektroliteve dhe në qoftë se nuk kontrollohen rregullisht elektrolitet në gjak (sidomos kaliumi), mund të arrihet deri në veprimin toksik të kardiotonikëve dhe të shfaqet rreziku i aritmisë etj.

Preparatet e tetraciklinave

Barnat si: Amracina, Geomicina, Chymocikclari etj. ndërveprojnë me:

- *ushqimin që përmban kalcium, qumështin dhe prodhimet e tij, preparatet kundër thartirës së lukthit si antacidet (*GELUSIL LAC, KOMPENSANI *etj.)* duke zvogëluar resorbimin edhe efektin e preparateve të tetraciklinave
- *penicilinat* duke e zvogëluar efektin e tyre.

BARNAT QË NDIKOJNË NË AFTËSITË SEKSUALE

Përdorimi i barnave kërkon njohuri jo vetëm për shqetësimet apo sëmundjet ku mund të përdoren dhe për mënyrën e përdorimit të tyre por edhe për mundësinë e paraqitjes së efekteve anësore që shkaktohen nga përdorimi i tyre, siç është p. sh. ndikimi në aftësitë seksuale (impotenca). Ky problem në të shumtën e rasteve anashkalohet si nga ana e mjekut dhe e farmacistit, po ashtu edhe nga vetë i sëmuri i cili këtë problem e trajton si të vetin, duke iu shmangur konsultimeve me mjekun apo farmacistin. Çrregullimet seksuale në të shumtën e rasteve paraqiten si pasojë e përdorimit të barnave apo preparateve kundër shtypjes së lartë të gjakut. Duke pasur parasysh se mbi 20% e popullatës mbi moshën 18 vjeçare vuajnë nga shtypja e lartë e gjakut, e që gjatë gjithë jetës së tyre duhet të përdorin këto barna, atëherë ky problem duhet të merret me seriozitet sepse shpeshherë këta të sëmurë e ndërpresin marrjen e këtyre barnave, e kjo mund të çojë deri në çrregullime të rënda të organizmit. Praktikisht përdorimi i këtyre barnave është i përjetshëm, dhe si i tillë mund të çojë deri te kjo dukuri e padëshiruar që në shumë raste e "detyron" të sëmurin të ndërpresë marrjen e tyre ose ndërrimin me barna të tjerë. Këtë problem i sëmuri e ka "vështirë " ta paraqesë te mjeku ose te farmacisti, dhe ai ndërpren marrjen e këtyre barnave pa u kosultuar, duke mos llogaritur se pasojat janë të mëdha , deri te ato fatale. Në grupin e barnave që përdoren kundër shtypjes së lartë të gjakut e që mund të shkaktojnë çrregullime seksuale bëjnë pjesë: Gvanetidina, Klonidina, Prazosina, Rezerpina, Spirolaktoni dhe diuretikët tiazidë. Për sa i përket përdorimit të beta-blokatorëve, meqë kanë lipofili më të pakët se propranololi dhe për pasojë hyjnë më me vështirësi në sistemin nervor qendror, mundësia që të shkaktohen çrregullime seksuale është më e vogël. Ndërsa prej barnave që përdoren kundër të thatit (ulcerës) nga grupi i H2

receptorëve , veprim kundër - androgen (që mund të shkaktojë çrregullime seksuale), sidomos te femrat ka vetëm Cimetidina. Duhet pasur parasysh se mund të çojnë në çrregullime seksuale edhe barnat që përdoren si qetësues të sistemit nervor qendror.

L[30]

BARNAT QË RRISIN EFIKASITETIN E MARDHËNIEVE SEKSUALE

Potenca është dukuri e cila manifestohet me probleme në marrëdhëniet seksuale.

Për këtë arsye, shkencat farmaceutike duke kërkuar zgjidhjen e këtij problemi sot në treg kanë futur në qarkullim barna, të cilët rrisin potencën në marrëdhëniet seksuale. Bari i parë të cilin e ka futur në treg industria farmaceutike është *Sinadelfil citrate*, i njohur me emrin *Viagra*.

Sinadelfil citrate - Viagra

Kjo lëndë në fillim është përdorur për mjekimin e hipertensionit. Pacientët (shumica e të moshuarve) pas marrjes së këtij bari për tension të gjakut jo që ishin ndier mirë-mjekuar nga hipertensioni, por ishin ndier shumë mirë edhe në ereksion. Për këtë pacientët të cilët kishin përdorur një herë, e kërkonin prapë. Kjo ndikoi që të bëheshin hulumtime të mëtutjeshme dhe shkencëtarët (njëri prej tyre me prejardhje shqiptare - Ferid Murati) arritën në përfundim që këtë bar ta përdorin për rregullimin e problemeve seksuale.

Substanca Sinadelfil veprimin e vet e ka në bllokimin e enzimit fosfo-diesterazës PDE, me ç'gjë zgjat kohën e ereksionit te meshkujt.

Mekanizmi i veprimit

Mashkulli, i cili ngacmohet seksualisht më mbaresat nervore, aktivizon guanovin monofosfatin treciklik cGMP, i cili bën dilatimin e enëve të gjakut. Kjo bën që penisi të mbushet me gjak - në saje të indeve shpuzore, dhe kështu penisi merr forcë. Enët e gjakut që janë të dilatuara, bëjnë shtypje në vena, dhe në këtë mënyrë bëjnë që gjaku të qëndrojë gjatë në penis. Forca e tij qëndron gjatë dhe pas orgazmës kthehet në gjendjen e mëparshme normale (kthimin në gjendje normale e bën enzimi i PDE, i cili shkatërron cGMP-në).

Në jetën normale Sildenalfili merret si sistem doping. Mashkullin, i cili nuk ka dëshirë për seks, Sildenalfili nuk e ndihmon - nuk mund të ketë veprim të kërkuar.

Sildenalfili nuk duhet të përdoret gjatë.

Ka këto anë negative:

Halucinacionin, të bardhët e syrit - nuk dallohet mirë ngjyra e kaltër, e gjelbër, dhjetë për qind të rasteve kanë kokëdhembje. Personat me hipertension të cilët marrin edhe antihipertensiva të tjerë, humbasin vetëdijen nga hipotensioni i shpejtë. Duhet të kenë kujdes ata që janë me sëmundje koronare. ***(Prospekti Viagra)***

Verdenafil hidrokrolruri trihidrat - Levitra

Së paku një nga dhjetë meshkuj gjatë ndonjë periudhe të jetës kanë probleme që të arrijnë fortësinë e mjaftueshme të organit seksual për kryerjen e marrëdhënies normale seksuale (çrregullimi erektil). Shkaktarët e kësaj mund të jenë organikë, psikologjikë, por më së shpeshti është kombinimi i këtyre dy faktorëve. Pavarësisht nga shkaktari, pasoja është e njëjtë: shkaktohen ndryshime në muskulaturën e enëve të gjakut, të cilat pamundësojnë mbajtjen e gjakut në organin seksual mashkullor, i cili do ta bënte dhe do ta mbante atë të fortë.

Arritja e fortësisë së organit seksual mashkullor (ereksioni) varet nga baraspesha e dy substancave në organizëm. Njëra mundëson ereksionin, ndërsa tjetra të kundërtën. Te meshkujt e

shëndoshë veprimi i këtyre dy substancave është në baraspeshë. Nëse prishet kjo baraspeshë, bie aftësia e organit seksual mashkullor për të kryer aktin seksual (çrregullimi ereksional). VARDENAFILI e zvogëlon veprimin e substancës së dytë (të quajtur PDE-5) dhe mundëson që të arrihet dhe të mbahet ereksioni. Merret rreth 25 deri në 60 minuta para marrëdhënies seksuale dhe vepron vetëm nëse keni stimulim seksual.

(Prospekti Levitra)

Tadalafili me emrin tregtar Cialis

Terdenafili është një substancë e cila ka mekanizëm të ngjashëm të veprimit sikurse edhe dy substancat e mëparshme, vetëm se veprimin e ka më të gjatë. Mekanizmi i veprimit bazohet në zgjerimin e enëve të gjakut në organin seksual mashkullor (ku edhe bën grumbullimin e gjakut) me ç'gjë atij ia rrit fortësinë dhe kohën e ereksionit. Ky bar përdoret edhe te të sëmurët me hipertension pulmonar. Koha e veprimit të këtij bari është e ndryshme nga ajo ditorja në doza 2,5 mg deri 5 mg deri tek ajo në afat prej 36 orëve në doza nga 5 deri në 10 mg. Veprimi i tij fillon pas 30 minutash.

Duhet t'i kemi parasysh disa nga këto të dhëna para se ta përdorim:

- nuk duhet të jemi pacientë me sëmundje të zemrës, të veshkave , të mëlçisë, të shtypjes së lartë të gjakut;
- nuk duhet të përdorim barna të tjerë, sidomos të grupit të nitrateve (nitroglicerinë etj.);

Si edhe dy barnat e mëparshëm edhe ky bar ka efektet anësore të njohura si dhimbje koke, zënie të hundëve ose lëngësim nga hundët, ushtimë të veshëve etj. Këto efekte anësore zakonisht zhduken pas disa orësh. Në rast se efektet nuk zhduken për një kohë të gjatë, duhet t'i drejtohemi mjekut. ***(Prospekt i Cialis)***

NDIKIMI I BARNAVE NË REZULTATET E ANALIZAVE LABORATORIKE

Në analizat e ndryshme laboratorike përveç ushqimit dhe faktorëve të tjerë, të cilët japin rezultate të rreme pozitive apo negative, rol të rëndësishëm luan edhe prania (përdorimi) e barnave në organizëm. Në disa raste duhet të kemi kujdes edhe në intervalin kohor me ditë ose javë (për shkak të gjysmëjetës së barit në organizëm).

Ndikimit të barnave-medikamenteve i nënshtrohet çdo rezultat biokimik, sado që është punuar me metoda precize dhe specifike siç është edhe ajo enzimatike.

Shumica e medikamenteve veprimin e tyre e bazojnë nëpërmjet të metabolitëve të tyre, ndërsa disa veprojnë drejtpërdrejt në shkaktarët, të cilët nxisin rritjen ose uljen e vlerave të kërkuara të analizave laboratorike (p. sh. : shumica e kimoterapeutikëve etj).

Veprimi i medikamenteve në rezultatet laboratorike varet nga:

përqëndrimi, pasia e dhënë, struktura kimike, zbërthimi, gjysmëjeta e shkatërrimit, eskrecioni,

Mjeku, specialisti duke pasur parasysh veprimin e medikamenteve në rezultatet laboratorike nuk duhet të kërkojë analiza laboratorike në të sëmurët e mjekuar me medikamente, të cilat ndikojnë negativisht në rezultatet laboratorike ose duhet të kenë parasysh vlerat e rritura ose të ulura si pasojë e ndikimit të barit të dhënë në analizën e kërkuar. Një mosrespektim i tillë sjell dëme të shumta për diagnostifikimin e saktë (i sëmuri pranon terapi joadekuate) për të sëmurin dhe për mjekun.

Me qëllim që të evitohet mundësia e rezultateve joreale është e udhës që para se t'i merrni barnat të këshilloheni (të pyetni mjekun ose farmacistin) se a mund t'i marrim ose a ka ndikim marrja e barnave të caktuara në rezultatet e analizave laboratorike.

Në fund të librit, në pjesën shtesë, ndodhen tabelat e barnave, të cilët ndikojnë në parametrat biokimikë dhe mikrobiologjikë.

SI DUHET T'I PËRDORIM BARNAT

Industritë farmaceutike (sot) në botë kanë prodhuar forma të ndryshme teknologjike të barnave, kështu që një bar - medikament paraqitet në disa forma. Nga forma e barit varet edhe (vendi) dhe mënyra e përdorimit. Çdo formë teknologjike (tableta, drazhe, pomada) kërkon mënyrën dhe dozën e drejtë të përdorimit.

Në shikim të parë ky udhëzim duket se nuk është aq interesant, mirëpo suksesi terapeutik varet pikërisht nga mënyra sesi duhet të përgatitet bari për t'u përdorur, si të dozohet, sa kohë duhet të përdoret, cilat efekte mjekuese do të arrihen, cilat efekte anësore mund të shfaqen etj.

Janë dhënë shënime dhe fotografi në mënyrë që praktikisht të shihet sesi duken format e barnave, si ruhen, si duhet të përgatiten ata dhe si duhet të përdoren. Kjo përfundimisht e përcakton efektin terapeutik të barit.

Për qëllime sa më praktike po japim disa udhëzime kryesore sesi duhet të përdoren format e caktuara të barnave.

Para përdorimit të çdo bari duhet të lahen duart mirë dhe të teren (të fshihen).

Ambalazhi duhet të hapet me kujdes në mënyrë që të mos krijojmë mundësinë e prishjes së barit pasi të hapet.

E shikojmë saktë se sa duhet të merret: nëse është tabletë duhet të shikohet se sa pjesë ose sa tableta duhet të përdoren menjëherë: a duhet të mbahet nën gjuha, a duhet të shkrihet në gojë, a duhet të merret para ushqimit apo mbas ushqimit, a duhet të përdoret me lëngje; kapsulat nuk duhet të ndahen; nëse është tretësirë duhet të dihet se me çfarë luge duhet të merret. Kjo ka shumë rëndësi, sepse tregon sa do të jetë sasia e nevojshme e barit që merret. Te tretësirat duhet të kemi shumë

kujdes gjatë përdorimit-duhet të dimë mirë nëse ajo është për t'u pirë, për ta lyer trupin apo për t'i larë flokët.

Udhëzimet e qarta të barnave, sidomos për gratë shtatzëna, për fëmijët dhe për të moshuarit, kanë rëndësi të jashtëzakonshme:

- Gratë shtatzëna, të shumtën e kohës kanë probleme shëndetësore dhe për t'i lehtësuar këto probleme, kërkojnë të përdorin barna.
-
- Fëmijët nuk i marrin me qejf, dhe për pasojë nuk e marrin dozën e dëshiruar ose nuk e marrin fare.

- Të moshuarit i harrojnë barnat ose i ngatërrojnë gjatë marrjes.



Kutia kujtuese e marrjes së barnave brenda 24 orëve

TABLETAT, DRAZHETË DHE KAPSULAT PËR PËRDORIM ORAL (NGA GOJA)

Tabletat janë forma të forta të barnave. Përdoren nga goja (në mënyrë orale), thithen në hapësirën e gojës, në lukth dhe/ose zorrë. Punohen në forma të ndryshme, si pllakëza të rrumbullakëta ose ovale me sipërfaqe të rrafshtë ose lehtësisht konvekse, të lëmuara, me anë të rrumbullaksuara njësoj.

Në bazë të mënyrës dhe synimit të përdorimit, tabletat mund të ndahen në LINGUALETA, EFERVETA, DRAZHE, FILM-TABLETA, ORIBLETA, SOLUBLETA. Ka edhe një lloj të veçantë tabletash që përdoren me rrugë vaginale, VAGINALETE (shih më poshtë).

- **Lingualetat** janë tableta që vehen nën gjuhë dhe substancat mjekuese resorbohen, thithen nëpërmjet mukozës së gojës.
- **Efervetat** janë tableta që para përdorimit shkrihen në ujë dhe pihen në formë lëngu - limonade.
- **Drazhetë** janë tableta të mbuluara me sheqer.
- **Filmtabletat** janë të mbuluara me një film të hollë me prejardhje natyrore ose sintetike. Trashësia e këtij filmi është shumë e vogël rreth, 100 mikrometër.
- **Solubletat** janë tableta për përdorim të jashtëm që pas shkrirjes, përdoren lokalisht (shih më poshtë).

TABLETAT

Tabletat në përgjithësi kanë disa karakteristika që duhet pasur parasysh para përdorimit të tyre.

Tabletat janë kokrra të forta, me formë dhe madhësi të ndryshme (të rrumbullakët etj., pesha 0.5-1 g), me ngjyrë ose pa ngjyrë, të ndara me vija, të ambalazhuara në folie ose shishe. Para se të përdoren duhet të dimë se a po i marrim tabletat, të cilat na i ka përshkruar mjeku, si dhe a po u përmbahemi rregullave, të cilat na i ka dhënë farmacisti.



Ruajtja e tyre duhet të bëhet në bazë të standardeve që kërkon bari i caktuar. Sidomos është me rëndësi që ato të ruhen (lihen) në vende ku ndryshimi midis temperaturës së ulët dhe të lartë të jetë sa më i vogël. Kjo mundëson që lagështia ndaj së cilës tabletat janë shumë të ndieshme, të mënjanohet. Gjithashtu tabletat duhet të mbrohen nga drita. Tabletat nuk duhet të ruhen në frigorifer, kuzhinë, banjë dhe në vende të tjera që përmbajnë lagështirë.

Lidhur me tabletat që janë të mbuluara me një cipë të hollë filmor duhet që të hapet vetëm tableta, e cila do të përdoret, ndërsa tjerat ruhen të paprekura. Për tabletat, të cilat jepen në shishe duhet pasur kujdes që shishja, pas marrjes së tabletës, të mbyllet mirë dhe menjëherë.

Tabletat, të cilat duhen të kapërdihen, gëlltiten pa u përtypur dhe merren me pak ujë.

Në formë të tabletave ndodhen: *Analgina, Aspirina, Diklofenaku* etj.

LINGUALETAT
(TABLETAT QË MBAHEN NËN GJUHË)

Lingualetat janë përgatitje të barnave që detyrimisht duhet të thithen në hapësirën, zgavrën e gojës.

Lingualetat janë pllakëza të rrumbullakëta, të forta me sipërfaqe të rrafshtë apo konvekse që përdoren duke i vënë nën gjuhë. Punohen në mënyrë të tillë që të treten në lëngun e gojës pa qenë nevoja për të dhënë mjete të tjera për zbërthimin dhe thithjen e tyre. Ato zbërthehen e thithen gradualisht brenda një kohe relativisht të shkurtër, deri 30 min.

Merren në këtë mënyrë: pastrohet hapësira gojore, vihen nën gjuhë, në mënyrë që lënda mjekuese të resorbohet më shpejt dhe të veprojë më shpejt.

Duhet të ruhen në vende të terura dhe të mbrojtura nga lagështira.

Në formë të ligualetave përdoren: vazodilatorët, disa hormone dhe disa barna që shkatërrohen në traktin digjetiv.

Në formë të lingualeteve ndodhen*: Nitroglicerina, Tinidili* etj.

DRAZHETË



Drazhetë janë forma të rrumbullakëta, vezore të tabletave të mbulura me një shtresë të hollë të sheqerosur, që përdoren dhe ruhen njësoj sikur tabletat.

Veshja e tyre e sheqerosur e mbron lëndën vepruese të drazheve nga veprimi i lëngut tretës të lukthit (veprim i cili do ta shkatërronte lëndën vepruese), e mbulon erën dhe shijen e padëshiruar etj. Për këtë arsye gjatë marrjes-përdorimit nuk duhet të dëmtohen (nuk duhet të ndahen).

Veshja sheqerore "zhveshet" në mjedisin e zorrës dymbëdhjetëgishtore e në fillim të zorrës së hollë, pikërisht aty ku pritet zbërthimi dhe veprimi mjekues i drazheve. Veshja e tabletave në formë të drazheve është e domosdoshme, sidomos për barnat enzime që duhet të veprojnë në zorrë për tretjen e ushqimeve, maskimin e shijes, aromës etj.

Në formë të drazheve ndodhen: *Buscopani, Beviplexi, Dulcolaxi* etj.

TABLETAT PËR THITHJE DHE VEPRIM LOKAL (ORIBLETTAE)

Oriblетat janë përgatitje të forta të barnave të dedikuara për veprim lokal në mukozën e gojës dhe të fytit. Kanë formë të rrumbullakët ose eliptike me sipërfaqe të rrafshta (konvekse) dhe të rrumbullakësuara.

Më shpesh lëndët vepruese të oriblетave janë lëndë dezinfektuese, antibiotikë, anestetikë lokalë dhe ekspektorante, janë tableta me përmasa më të mëdha se tabletat e zakonshme. Paketimet e tyre janë zakonisht si të tabletave. Karakteristikat e ruajtjes gjithashtu janë të njëjta si te tabletat. Ato përdoren zakonisht si karamele duke marrë tabletën dhe duke e shkrirë gradualisht në gojë (sa më gjatë që mbahen në gojë, aq më i fortë është veprimi i tyre).

Merren në këtë mënyrë: zakonisht merren pas ushqimit dhe pastrimit të gojës dhe mbahen në gojë derisa të shkrihen. Nuk duhet të grimcohen për shkak se ato duhet të shkrihen ngadalë, në mënyrë që të arrijnë veprimin e tyre lokal në hapësirën e gojës dhe të fytit.

Duhet të ruhen në vende të terura dhe të mbrojtura nga lagështira.

Në formë të oriblетeve ndodhen: *Septoletet, Fitosepti, Panthenoli, Ekosepti* etj.

TABLETAT SHKUMUESE (EFERVETAT)

Efervetet janë përgatitje të forta të barnave të cilat para përdorimit shkrihen në ujë dhe pihen në formë lëngu (limonade).

Zakonisht përmbajnë vitamina, minerale etj. Duke pasur parasysh se përmbajtja e tyre shpeshherë mund të jetë në bashkëveprim me ushqimin, marrja e tyre duhet të bëhet sipas kërkesave të fletudhëzuesit. P.sh. në rast se duhet përdorur kalciumi dhe preparatet e tij, duhet ditur se kalciumi jepet me acidet yndyrore që janë në përbërje të yndyrave ushqimore, sapunë kalçikë të patretshëm. Në këto raste kalciumi nuk hyn dot në organizëm, sepse nuk e kapërcen "murin" e zorrës. Prandaj këshillohet që preparatet e kalciumit të merren më mirë larg ushqimit.

Në formë të efervetеve ndodhen:*Ca-C 500 Sandoz, Vitamina C, Multivitamina, Aspirina C* etj.

KAPSULAT MJEKUESE (CAPSULAE MEDICINALES)

Kapsulat medicinale janë përgatitje barnash që përmbajnë sasinë e dozuar të lëndës / lëndëve vepruese shëruese brenda një cipe të fortë ose të përkulshme me të cilën mbështillet në dozë unike lënda vepruese e ngurtë, e butë ose e lëngët. Në organizëm duhet të tretet, të zbërthehet, pastaj të përthithet. Përdoren në mënyrë orale, resorbohen në lukth ose zorrë, varësisht nga qëllimi i përgatitjes. Për këtë arsye ato gjatë marrjes nuk duhet të hapen, të dëmtohen. Merren me pak lëng (jo të ngrohtë), në mënyrë që të kapërdihen lehtë.

Kapsulat kanë, zakonisht, formë cilindrike, vezore ose rrethore.

Në formë të kapsulave ndodhen: *Ampicilina, Hiconcili, Eglonyli* etj.



Uji jo i ngrohtë

TABLETAT PËR PËRDORIM TË JASHTËM (SOLUBLETAT)



Solubletat janë tableta, të cilat posedojnë formë të pllakëzave rrethore ose katrore. Ato shfrytëzohen për përgatitjen e tretësirave për përdorim të jashtëm, të cilat përm-bajnë sasi të caktuar të substancës mjekuese.

Punohen sipas rregullave të përgjithshme të përpunimit të tabletave. Ato treten lehtë në ujë, zakonisht brenda 10 minutave, në temperaturë 20 ºC ± 2 ºC .

Detyrimisht jipen me shënimin e dukshëm "Për përdorim të jashtëm" dhe të sëmurit duhet t'i tërhiqet vërejtja dhe t'i shpjegohet mundësia e helmimit.

Solubletat treten në sasinë e caktuar të tretësit. I sëmuri vetë apo familjarët e përgatitin tretësirën për kompresë, dezinfektim etj. Në grupin e solubletave futen edhe tabletat për dezinfektimin e ujit të pijshëm dhe tabletat për përgatitjen e tretvsirave titruese.

Solubleta, të cilat përmbajnë substanca me veprim të fortë (+) dhe shumë të fortë (++) janë të ngjyrosura me ngjyrë të kaltër të theksuar, e cila edhe tretësirën e ngjyros me të njëjtën ngjyrë (të kaltër). Solubletat, të cilat përmbjanë helme duhet të jenë të mbështjellura me letër të zezë në të cilën me ngjyrë të bardhë është shtypur koka e të vdekurit dhe shenja "helm" ☠. Në formë të solubleteve ndodhen*: tab. Burov* etj.

BARNAT E LËNGSHME QË KANË PËRDORIM TË BRENDSHËM

Barnat e lëngshëm-tretësirë, tretësirat e përqendruara (tretësirat e përqendruara të sheqernave që në gjuhën e popullit quhen shurupe), suspensionet ose pezullitë, emulsionet (që gjithashtu në gjuhën e popullit quhen shurupe) duhet të përdoren me një kujdes të veçantë. Duhet marrë këshillat e nevojshme, si:

- a duhet të përzihet (tundet) para përdorimit;
- a duhet të përdoret para apo mbas buke;
- me çka duhet të matet ose si duhet të matet marrja ose dozimi (nëse nuk e ka lugën e vet ose luga është e shkallëzuar me numra. Nëse bari merret në sasi të vogël sa nuk mund të matet me lugë, si duhet të masim - pikat si duhet t'i masim - p.sh. 1 ml tretësirë ujore ka afër 20 pika nga pikatorja standarde);
- a bën të përzihet me qumësht, ujë, lëngje etj. Këtu duhet të kemi kujdes të veçantë në përdorimin për fëmijë (nëse barin e përziejmë me lëngje ose me qumësht, duhet të mendojmë që fëmija sasinë e përzier ta pijë plotësisht, në të kundërtën nuk e merr dozën e duhur).

Pasi që tretësira hapet për t'u përdorur, sa ka kohë-afat të përdorimit etj.

Duhet të ruhen në vende të mbrojtura nga drita dhe temperatura.

PIKAT PËR GOJË (GUTTAE ORALES)

Pikat për gojë janë preparate të lëngëta mjekësore të përgatitura për përdorim oral, të cilat dozohen me pika. Në formë të pikave dozohen tretësirat e substancave mjekuese në ujë, etanol dhe vaj ose mikstura, të cilat përmbajnë substanca mjekuese me veprim të fortë, koncentrate të barnave ose ndonjë preparat ekstrakues të lëngët.

Pikat mund të jenë edhe suspensione, të cilat përmbajnë substanca me ndikim jo të fortë. Suspensionet patjetër duhet të jenë të pajisura me udhëzimin "të tundet para përdorimit".

Duke pasur parasysh se pikat janë në vëllim të vogël, mënyra e përdorimit duhet të jetë e qartë në momentine marrjes: nuk duhet që pikat të qiten në lugë të thatë sepse një pjes ë tyre mund të mbeten në lug dhe kështu nuk merret doza përshkruar. Andaj pikat(në numër të caktuar)duhet të qiten ose drejtërdrejt në gojë ose duhet të qiten në një lug në të cilën paraprakisht qesin pak ujë (nëse pikat janë tretësira ujore, ekstrakte bimore etj.) ose qumëssht nëse pikat janë tretësira vajore.

Pozita e pikatores ose bocës me pikatore duhet të jetë vertikale në mënyrë që shkputja e pikës të jetë e plotë.

Jepen në shishe me pikatore (vitrum gutatorium) .

Në formë të pikave për gojë ndodhen: *Redergin sol, AD3 sol, Ergotyl, Ditamin, Aktiferin* etj.

PËRDORIMI I SHURUPEVE

Shurupet janë preparate të lëngshme me përqendrim të lartë të sheqerit. Përbërës kryesor është sakarozi i tretur në ujë, lëngjet e pemëve ose ekstraktet e drogave. Pasi që sheqeri është përbërësi kryesor i shurupit, farmakopea kërkon që shurupet të përmbajnë së paku 45% sakaroz – për shkak të mbajtjes së një presioni osmotik, i cili pamundëson zhvillimin e mikroorganizmave (më së shumti 64% për shkak se nuk janë stabile - kristalizohen).

Sqarimi i këtillë i shurupeve është në aspektin teknologjik (të mënyrës së përgatitjes dhe qëllimit të përdorimit-si korrigjues i shijes se çka nuk është në pajtim me praktikën e barnatoreve), sepse ata përgatiten për të përmirësuar shijen e preparateve mjekuese.

Në praktikën e përditshme në barnatore si shurupe konsiderohen tretësirat ujore, suspensionet, emulsionet, ekstraktet e lëngëta, të cilat përmbajnë lëndë vepruese të shoqëruara me lëndë ëmbëlsuese dhe aromatizuese, të cilat dozohen me lugë dhe përdoren nga goja.

Në praktikë(në barnatore) egzistojnë dy forma të shurupeve:

- shurupet e gatshme të përgatitura me rrugë industriale – në formë të tretësirave, pezullive të gatshme dhe
- shurupet gjysmë të gatshme (koncentrat) përgatitja e të cilave në formë të suspensioneve bëhet në barnatore.

Gati çdo shurup para përdorimit duhet të përzihet (tundet), sidomos pezullitë, emulsionet-shurupet që kanë fundërrinë ose faza të ndara. Kjo është thelbësore për përdorimin e shurupeve, sepse nëse nuk do të bëhej përzierja-tundja, doza e barit nuk do të merrej drejt. Gjithashtu shurupet, në bazë të veprimit dhe të karakteristikave të tyre farmaceutike, duhet të përdoren para ose pas ushqimit. Një numër i madh i antibiotikëve duhet të përdoren para ushqimit për shkak të thithjes më të mirë dhe efekteve të tjera terapeutike.

Shpeshherë në barnatore kërkohen shurupet pa udhëzim, përkatësisht pa recetë të mjekut. Kjo është me shumë rreziqe, sepse:

- nëse shurupi përmban antibiotikë dhe nuk merret antibiotiku adekuat dhe në dozë të duhur, mund të krijojë rezistencë, mund të shkaktojë alergji etj.;
- nëse kërkohet shurupi për kollë dhe nuk dihet se për cilën kollë është fjala, mund të arrihen efekte të kundërta.

Shurupet kundër kollës janë dy llojesh:

a. Ata që e ndalin kollën e thatë si FOLKODIN, SINEKOD dhe që përdoren para ushqimit;

b. Shurupet, të cilët pastrojnë rrugët e frymëmarrjes nga sekrecionet (është fjala për kollën “e njomë”) si MUCODYN, FENORIN etj. Para përdorimit të këtyre shurupeve është e këshillueshme që i sëmuri së pari të kollitet (për heqjen e mundshme të sekretit) dhe pastaj të merret shurupi, në mënyrë që të shmanget mundësia e nxjerrjes së shurupit jashtë me anë të vjelljes.

Është shumë e rëndësishme edhe dhënia e sasisë së duhur të shurupit (dozës) për arsye se sot gati 70% e shurupeve nuk merren në dozat e duhura për shkak se shumicës së tyre u mungojnë lugët. I sëmuri duhet të sqarohet për mënyrën e dozimit të shurupit nëpërmjet përdorimit të llojeve të ndryshme të lugëve matëse.

Për këtë arsye duhet të kemi të qartë për sasin e cila një lug e caktuar mundë të marr. P.sh.:

- Luga e madhe përmban rreth 15 ml.
- Luga e mesme përmbanrreth 10 ml.
- Luga e vogël përmbanrreth 5 ml.

Në formë të shurupeve ndodhen*: Ampicilina, My-codina, Bactrimi* etj.

BARNAT E LËNGSHËM QË KANË PËRDORIM TË JASHTËM

Barnat e lëngshëm që kanë përdorim të jashtëm, të shumtën e rasteve, nga pakujdesia por edhe nga mosnjohja e mënyrës së përdorimit, kanë qenë rrezik për jetën e të sëmurit. Për të pasur një informacion themelor, po japim një grupim të tyre dhe mënyrën sesi ata të përdoren.

a. Barnat në gjendje të lëngshme për përdorim në hapësirën gojore

Barnat e lëngshëm, si peroksidi i hidrogjenit 3%, heksatidina (Hexoral), ekstrakte të mentës, të kamomilit etj., nuk duhet të kapërdihen, por të mbahen disa sekonda (afërsisht 30 sek.) në gojë dhe të hidhen;.

b. Barnat në gjendje të lëngshme për përdorim të jashtëm-në lëkurë, flokë etj.;

Në formë të barnave të lëngshëm që përdoren në lëkurë janë: dezinfektuesit e lëkurës (Acidi borik 3 %, Hidrogjeni 3%, Rivanoli, Jodi, etj.) antimikrobikët (kundër zgjebes – benzyl-benzoati, sulfuri etj., kundër morrave-shamponi etj.).

Marrja dhe siguria e këtyre barnave kërkon një kujdes të veçantë, sepse nga praktika e deritashme është treguar se shumica e këtyre barnave janë dhënë në mënyrë të gabuar: në vend se të jepen për përdorim të jashtëm, ata janë pirë, sidomos i kanë pirë fëmijët.

PËRDORIMI I SHAMPOVE KUNDËR MORRAVE

Shampotë kundër morrave hyjnë në kategorinë e barnave mjaft të rrezikshme, sidomos për fëmijët, prandaj ato duhet të ruhen mirë dhe të fshehen nga fëmijët. Praktika ka treguar se ka raste kur disa nëna kanë bërë gabime të rënda gjatë përdorimit të këtyre shampove siç është rasti më i ri i një nëne që shamponë Milinor ia ka dhënë fëmijës për uljen e temperaturës së lartë. Përgjithësisht, këto lloj shamposh përdoren në këtë mënyrë:

-para përdorimit duhet të përzihen mirë, mandej flokët pasi lagen (njomen) me ujë, merren rreth 15 ml shampo (sasia varet edhe nga lloji i shamposë) për fëmijë të moshës deri 10 vjeç. Për të rriturit, merren 30 ml dhe qiten në flokë duke i fërkuar vazhdimisht me maje të gishtave për 4 minuta. Flokët duhet të mbulohen me shkumë, sidomos rreth veshëve. Pastaj flokët shpëlahen dhe me anë të të krehurit bëhet krehja e flokëve duke u kujdesur që papastërtitë – morrat të bijnë në një vend të dukshëm.

Duhet të kemi kujdes që gjatë aplikimit dhe veprimeve të theksuara, t'i ruajmë sytë dhe gojën.

Shampoja nuk duhet të përdoret më tepër se dy herë në javë dhe së paku 24 orë ndërmjet tyre.

Duhet të ruhen në vende të mbrojtura nga drita dhe temperatura.

Ruhen të mbrojtur nga fëmijët.

Në formë të shamponit ndodhen: *milinori, gamexi, bubili* etj.

Baranta kundër zgjebes

Duhet të dimë se zgjebja është një sëmundje që përfshin sipërfaqe të madhe të trupit (të shumtën e rastit edhe gjithë trupin), andaj trupin e papastruar duhet ta lyejmë të tërin tri ditë me radhë. Trupi nuk bën të lahet për tri ditë rresht. Pastaj pastrohet dhe rrobat e palara duhet të zihen. Duhet të kemi kujdes që gjatë aplikimit dhe veprimeve të theksuara të mos preken sytë dhe goja.

Barnat duhet të ruhen në vende të mbrojtura nga drita dhe temperature.

Të mbrohen nga fëmijët.

Kapaku shërben për t'u matur sasia dhe pastaj qitet në duar . Kujdes mos të preken sytë dhe goja!

Duar fërkohen në mënyrë që të shpërdahet shamponi në gjithë sipërfaqen

Pastaj me duart e shamponuosura i fërkojmë flokët dhe me maje të gishtërinjve duke i fërkuar flokët bëjmë presion mbi morrat për 4 minuta.



Pastaj flokët shpërlahen me ujë dhe krihen në një vend të sigurt (shami) për të izoluar morrat, të cilët janë të alivanosur apo nuk i ka zhdukur shamponi

BARNAT QË APLIKOHEN(PËRDOREN) NË REKTUM DHE VAGINË MIKROKLIZMAT

Mikroklizmat janë preparate, të cilat përdoren sidomos te gjendjet akute.

Ato përdoren në këtë mënyrë:

Së pari hiqet mbyllësi (kapaku), pastaj gjithë majën e fusim në anus (kujdes, mos e përdor forcën) dhe me shtypje të fortë (me gishtin e madh dhe gishtin tregues) e zbrazim përmbajtjen e tubës dhe ashtu (të shtypur) e mbajmë derisa ta heqim nga anusi.

Në formë të klizmave ndodhen: *Medilax, Diazepam, Baby lax* etj.





E shtypur duhet të mbahet deri sa të hiqet nga rektumi



Pozita e trupit duhet të jetë e tillë sa zorrët të mos jenë të ngjeshura për t'u lënduar dhe bari të lëshohet në vendin e duhur.

SUPOZITORIET (SUPOSTET)

Supozitoriet në kuptimin e gjërë të fjalës, janë forma farmaceutike gjysëm të forta, të dozuara, që përdoren nëpërmjet rektumit (zorrës së trashë). Me anë të supozitorëve mund të arrihet veprim terapeutik i përgjithshëm sistematik dhe lokal.

Para se të vendosim suposten duhet që i sëmuri të defekojë.

Fillimisht duhet të shikojmë se a janë supozitorie të buta apo jo. Në qoftë se janë të buta, ato duhet të vendosen për një kohë të shkurtër në ujë të ftohtë ose frigorifer (pa ia hequr mbulesën) për t'u forcuar. Pastaj me kujdes iu hiqet mbulesa dhe në qoftë se buzët janë të mprehta shmangen duke i ngrohur e punuar me duar. Pastaj suposta njomet (laget) me ujë të ftohtë. I sëmuri duhet të shtrihet anash duke i mbledhur gjunjtë lart. Pastaj vendosen supozitoriet me kujdes në vendin e jashtëqitjes (anus), në mënyrë të tillë që pjesa më e hollë konike (maja) të futet, në fillim shtyhet me gisht, por pa forcë. Futja e tij në pjesë të caktuara të rektumit ka rëndësi të madhe, sepse varësisht se në cilën pjesë të rektumit vendoset, varet edhe mënyra e drejtë e resorbimit. Kjo është e rëdësishme, sidomos për barnat me veprim sistemik. Andaj, futja duhet të bëhet deri në pjesën e venës së poshtme dhe të mesme (jo shumë thellë- në venën e sipërme), në mënyrë që bari pasi të resorbohet dhe të kalojë në gjak, të anashkalojë mëlçinë, ku mund të shkatërrohet pjesërisht ose plotësisht.

Pas kësaj i sëmuri duhet të qëndrojë shtrirë për disa minuta.

Pastaj pastrohen duart.

Në formë të supposteve ndodhen: *Efferarlagn, Diklofenak, Modolex* etj.





Pozita trupit duhet të jetë e tillë sa rektumi dhe zorrët të mos jenë të ngjeshura për t'u lëduar dhe bari të resorbohet në venën e poshtme dhe të mesme.

PËRDORIMI I KREMIT, I POMADËS APO I XHELIT NË VAGINË

Ka edhe forma të tjera barnash me përdorim lokal dhe të përgjithshëm.

Kështu, ekzistojnë një numër kremësh, pomadash apo xhelesh, të cilat duhet të përdoren brenda në vaginë. Përdorimi i tyre bëhet në këtë mënyrë:

Së pari hiqet tapa nga tubi, në tubë vendoset aplikatori dhe tubi shtrydhet derisa aplikatori të mbushet me masën e dalë nga tubi.

Aplikatori hiqet nga tubi dhe lyhet me një sasi të vogël të kremit nga jashtë.

E sëmura shtrihet në kuriz, gjunjtë mblidhen pak dhe hapen anash. Aplikatori vendoset sa më thellë të jetë e mundur në vaginë, por jo me forcë. Me një dorë mbahet një shiringë e veçantë, koka e së cilës futet në aplikator, ndërsa me dorën tjetër shtypet pistoni në mënyrë që masa e barit të hyjë në vaginë. Pastaj aplikatori hiqet nga vagina. Në qoftë se është për një përdorim, aplikatori hidhet, në qoftë se është për shumë përdorime aplikatori pastrohet mirë me ujë të vëluar dhe thahet për të shmangur plotësisht lagështinë.

Në formë të kremit vaginal ndodhen: *Cansen, Kanseni* etj.



Vendoset shiringa në tub, dhe nga tubi tërhiqet sasia e nevojshme (tubi është i shkallëzuar)
dhe pastaj në tub vendoset aplikatori.



Pozita e trupit duhet të jetë e tillë
sa të mos lëndohet vendi i aplikimit
dhe bari të qitet në vendin e duhur.

TABLETAT VAGINALE (VAGINALETAT)

Vaginaletat, ose tab-letat vaginale janë preparate mjekuese të forta me formë ovale ose vezore me anë të tëho-lluara. Punohen si table-tat duke përdorur lëndë ndihmëse që treten lehtë në sekretin vaginal.

Në përbërje të vaginaletave hyjnë këto lëndë: antiseptikë, mjete dezinfektuese, antibioti-kë, antifungicid etj. Du-het të treten në tem-peraturën e trupit 37ºC për 20 minuta. Shër-bejnë për mjekimin e disa sëmundjeve të mu-kozës vaginale. Në sekretin vaginal duhet të treten lehtë.

Tabletat vaginale duhet të vendosen në vaginë në këtë mënyrë:

Së pari në qoftë se tableta është me mbulesë i hiqet mbulesa, pastaj njomet me pak ujë të vakët. E sëmura duhet të qëndrojë shtrirë në kurriz, gjunjtë mblidhen pak përpara dhe hapen anash. Tableta duhet të vendoset me kujdes në vaginë sa më thellë të jetë e mundur, duke mos e përdorur forcën. Zakonisht përdoren një herë në ditë, është e kështillueshme të përdoret në mbrëmje.

Ruajtja është e njëjtë si te tabletat tjera.

Në formë të vaginaleteve ndodhen*: Nystatin* etj.



Pozita e trupit duhet të jetë e tillë sa të mos lëndohet vendi i aplikimit dhe bari të qitet në vendin e duhur.

PËRDORIMI I POMADËS (PËR HEMORROIDE) NË REKTUM

Ekzistojnë një numër i madh i preparateve (barnave) të cilat përdoren në formë të pomadave për hemoroide (majasëll) nëpërmjet futjes në rektum.

Për aplikimin e tyre:

- së pari duhet të bëhet jashtëqitja (defekimi), në mënyrë që rektumi të pastrohet sa të jetë e mundur më mirë.
- nga tubi hiqet tapa, pastaj në tub vendoset aplikatori dhe tubi shtrydhet derisa aplikatori të mbushet me masën e dalë nga tubi.

I sëmuri shtrihet, gjunjtë mblidhen pak dhe hapen anash. Aplikatori futet në anus dhe vendoset në rektum, por jo me forcë. Pas vendosjes shtypet tubi në mënyrë që masa e barit të hyjë në rektum. Pastaj aplikatori hiqet nga rektumi, pastrohet mirë me ujë të vëluar dhe thahet nga lagështia e mundshme. Kjo procedurë mjekimi e hemoroideve bëhet tek të sëmurët që hemoroidet nuk i kanë të ndërlikuara me gjakderdhje. Te të sëmurët me hemoroide me gjakderdhje duhet të përdoren vetëm yndyra dhe ajo gjatë natës thellë në rektum. Aplikimi bëhet nëpërmjet një tamponi prej gaze të lyer me pomadë. Në formë të pomadës ndodhen: *Modolex, Factu, Delmeson* etj.

Maja e tubit duhet të lyhet (ose nëse është me vrima duhet të shtypet tubi deri sa bari të dalë pak nga tubi), në mënyrë që të depërtojë më lehtë në vendin e aplikimit si dhe gjatë rrugëtimit të mundësojë lyerjen anësore të rektumit.



Pozita e trupit duhet të jetë e tillë sa rektumi dhe zorrët të mos jenë të ngjeshura për t'u lënduar.

PËRDORIMI I POMADAVE PËR LYERJE TË LËKURËS

Yndyrërat (pomadat) janë preparate mjekuese të yndyrshme gjysmë të ngurta për përdorim të jashtëm, të cilat shërbejnë për mjekimin e sëmundjeve të lëkurës, të mukozave si dhe të plagëve.

Pomadat mjekuese përmbajnë lëndë shëruese ose mbrojtëse, të cilat mund të jenë të tretura, të suspenduara ose të emulguara në bazën e përshtatshme yndyrore (eksipientin). Pomadat apo yndyrat mjekuese në temperaturë të zakonshme kanë një konzistencë gjysmë të ngurtë (të butë), e cila duhet të shpërndahet lehtë, në vendin e sëmurë në një shtresë të hollë, nëpërmjet lyerjes së vendit të sëmurë. Pomada duhet të qëndrojë për një kohë të gjatë në vendin e aplikimit dhe të

mundësojë një kontakt të qëndrueshëm (të vazhdueshëm) midis barit (ilaçit) dhe lëkurës.

Përdorimi i tyre në lëkurë është i ndryshëm, por ekziston një rregull i përgjithshëm. Pomadat duhet të shtrihen në një shtresë të hollë duke bërë masazh të lehtë në to. Te disa pomada (është kështillë edhe e prodhuesit) duhet që pas përdorimit / aplikimit vendi i mjekuar të mbulohet / mbështillet me një gazë sterile. Ka edhe pomada që nuk duhet të vihen në lëkurën e dëmtuar – në plagë.

Në formë të pomadave ndodhen: *Synolar, Esperson, Gentamy-cina, Kuteridi, Bivacyna* etj.

PËRDORIMI I XHELEVE PËR LYERJEN E GOJËS

Xhelet zakonisht përdoren për lyerjen e hapësirës gojore.

Përdorimi bëhet në këtë mënyrë:

Në bazë të dozës, të cilën e cakton mjeku xheli merret dhe futet në gojë, mbahet aty për disa minuta dhe mandej kapërdihet në lukth. Përdorimi i xhelit bëhet të paktën dy orë para buke ose 20 minuta pas buke. Me xhelet për lyerjen e gojës mund të lyhen edhe protezat e dhëmbëve dhe të lihen të qëndrojnë gjatë gjithë natës. Në mëngjes protezat pastrohen.

Në formë të xheleve ndodhen: *Dactarina, Dactanoli* etj.

PËRGATITJA DHE PËRDORIMI I BARNAVE PLUHUR

Një pjesë e barnave ndodhet në formë të pluhurit. Mënyra e drejtë e përgatitjes dhe e përdorimit të tyre luan rol të rëndësishëm në veprimin e dëshiruar.

Kështu për shembull gjatë kohës së verës rritet shumë përdorimi i barnave në formë pluhuri, për shkak të barkqitjeve të shpeshta gjatë të cilave humbet sasi e konsiderueshme e lëngjeve dhe elektrolitëve nga organizmi. Në barnatore gjithmonë duhet të gjenden barna në formë të pluhurit në qese prej letre, të cilat përgatiten dhe përdoren në shtëpi. Para përdorimit merret një sasi e caktuar uji, p. sh. për NELIT një litër. Uji filllimisht vlohet dhe pastaj ftohet. Në ujin e ftohur tretet (duke e përzier) e gjithë përmbajtja e qeses. Përdorimi i sasisë-dozës varet nga shkalla e dehidrimit të organizmit. I ngjashëm është edhe përdorimi i pluhurave të tjerë, të cilët mund të përgatiten edhe me çaj, qumësht, lëngje të pemëve etj. Barnat pluhur që ndodhen në qeset e letrës nuk duhet të ruhen në frigorifer apo në vende ku temperatura është e luhatshme (në vende me lagështi).

Në formë të pluhrave ndodhen*: Neliti, Orosali, Beviplexi, Gelusili Lacti* etj.

Matet

Përzihet

Pihet

ÇAJRAT (SPECIES)

Çajrat janë përzierje të imtësuara njëtrajtësisht ose të paimtësuara të drogave bimore, të cilat mund të përmbajnë edhe substanca të ngurta mjekuese që kanë përdorim të jashtëm dhe të brendshëm.

Bimët mjekuese qysh në kohërat e lashta kanë qenë një alternativë e mirë e mbrojtjes së shëndetit, por edhe sot e kësaj dite përdoren gjerësisht. Bimët mjekuese në barnatore vijnë me emrin e çajrave. Çajrat janë forma të preparateve bimore mjekuese, të cilat përgatiten në forma të ndryshme në vartësi të pjesës së bimës që shërben si çaj dhe çfarë lënde përmban ajo. Kjo ka rëndësi të madhe, sepse varësisht nga pjesa e bimës (rrënjë, gjethe etj.) varet edhe dozimi dhe mënyra e përgatitjes së çajit, temperatura e përgatitjes (në vartësi të ndjeshmërisë së lëndëve vepruese ndaj nxehtësisë) etj. Një pjesë e bimëve kanë strukturë të fortë (përmbajnë substanca të qëndrueshme ndaj nxehtësisë), për rrjedhojë për nxjerrjen e substancave aktive duhet temperaturë e lartë. Sa për shembull po e përmendim përgatitjen e dy lloj çajrave të cilët përdoren më shumë në praktikën e përditshme.

*Rrënjët e mullagës së bardhë (*ATHAE RADIX*)* përmbajnë substanca jargore dhe të ndieshme ndaj nxehtësisë dhe për këtë arsye përgatiten me ujë të ftohtë në temperaturën e dhomës, ndërsa *fletët e gerdecit (çaji i* UVINIT - UVAE URSI FOLIUM*)* duhet të përgatiten pas vlimit të ujit dhe pastaj u hidhet sasia e përshkruar e çajit.

Në rast se një çaj nuk i ka të shënuara dozat dhe mënyrën e përgatitjes, duhen pasur parasysh disa parime bazë:

1. Çajrat që përmbajnë gjethe, lule dhe pjesë të gjelbërta, zakonisht përgatiten duke marrë një lugë të madhe (apo 3 gr), e cila hidhet në 200 ml ujë.

2. Nëse çaji përmban lëvore apo rrënjë bimësh zakonisht përgatitet duke marrë një lugë të vogël (apo 3 gr), e cila hidhet në 100 ml ujë. Në bazë të Farmakopesë çajrat nuk duhet të përgatiten dhe të përmbajnë droga me ndikim të fortë.

Meqë çaji përbëhen prej pjesëve të caktuara të bimëve (lules, fletës, frytit, farës etj.), si dhe karakteristikat e tyre (disa janë të buta dhe përmbajnë lëndë jargore, disa janë me inde të forta etj.) para se t'i përgatisim duhet të kemi parasysh dy veprime kryesore: 1. matjen dhe 2. mënyrën e përgatitjes.

1. **Matja -** nuk është e njëjtë për të gjitha pjesët e bimës dhe duhet të merret:

- **një lugë e madhe** (rreth 3 g) për çaj që përmban fletë, lule ose pjesë të gjelbra të bimës të grimcuara e të situra në sitën numër 6,
- **një lugë e vogël** (rreth 3 g) nëse çaji përmban lëvore, rrënjë, kërcunj, dru, ose fruta të grimcuar dhe të situr në sitën numër 3.

2. **Mënyra e përgatitjes** - varet drejtpërdrejt nga përbërja e pjesëve të bimës nga indet dhe lëndët mjekuese, të cilat janë të tretshme në kushte të caktuara.

Përgatitja bëhet a). në formë të macerateve, b). në formë të infuzave dhe c). në formë të dekokteve:

a). Në formë të macerateve (në temperaturë të dhomës) - përgatitet çaji që përmban pjesë të bimëve me lëndë mjekuese, të cilat janë të ndjeshme në temperatura të larta, siç është rasti i mullagës së bardhë.

b). Në formë të infuzave (me ujë të vluar) - përgatitet çaji që përmban pjesë të bimëve me lëndë mjekuese, të cilat janë të tretshme, por nuk avullohen në ujë të ngrohtë, siç është rasti me kamomilin etj.

c). Në forma të dekokteve (duke e vluar çajin) - përgatitet çaji që përmban pjesë të bimëve me lëndë mjekuese, të cilat treten në temperatura të larta, siç është rasti me pjesë të bimëve që përmbajnë alkaloide.

Para përgatitjes duhet të kemi parasysh edhe këto të dhëna:

- ***në cilin tretës-lëng treten (në ujë, në alkool...);***
- ***në cilën temperaturë;***
- ***a duhet të përzihen kohë pas kohe dhe***
- ***sa kohë duhet të presim për përgatitjen e tyre.***

Këtu duhet të përmendim edhe një të dhënë shumë të rëndësishme që çdo çaj duhet të lihet të qëndrojë për një kohë të caktuar (zakonisht 30 minuta) duke e përzier kohë pas kohe, në mënyrë që substanca mjekuese të çlirohet dhe të dalë nga pjesa e bimës të cilën e përgatitim si çaj. Këto veprime janë më se të domosdoshme për të fituar një çaj të efektshëm.

Çajrat duhet të ruhen në vende të thata, të mbrojtur nga lagështia.

Në formë të çajrave ndodhen: *çaji Gërdecit-fletë (UVAE URSI folium), çaji i Mullagës së Bardhë –rrënjët (ALTHAE RADIX), çaji i Senës-Fletët (SENAE folium)* etj.

Uji, i ftohtë apo i ngrohtë, bëhet sipas përbërjes së ÇAJIT

30 minuta bëhet ekstraktimi kohë pas kohe duke përzier.

Kullohet

Pihet

PËRDORIMI I SPRAJIT PËR PËRDORIM TË JASHTËM

Spraji është një formë e barit ku lënda vepruese (gazi) shpërndahet nën ndikimin e shtypjes së ajrit që ndodhet brenda në bocë.

Para përdorimit boca e mbushur me spraj tundet mirë, i hiqet kapaku dhe në largësi prej 15 –20 cm prej vendit ku aplikohet shtypet susta – siguresa, e cila e lëshon ajrin-barin brenda një kohe përafërsisht 1-2 sekonda në formë të shkronjës S prapsht. Pas përdorimit boca kthehet në anën e kundërt me kokë poshtë dhe shtypet siguresa për momentin. Në këtë mënyrë sigurohet ruajtja e cilësisë së lëndës në bocë.

Në formë të sprait për përdorim të jashtëm ndodhen: *Bivacyn, Geocorton, Teracortil, Betadine* etj.

AEROSOLI PËR GOJË

Para përdorimit oral të aerosolit (nëpërmjet gojës) duhet të kollitemi sa të jetë e mundur. Aerosoli para përdorimit duhet të tundet.

Përdorimi i aerosolit duhet të bëhet në bazë të udhëzimeve të prodhuesit: a.*(hiqet kapaku nga boca); b. (koka e bocës duhet të jetë poshtë dhe fundi lart);*: buzët puthiten te vendi ku del aerosoli*(maja e bocës duhet të vendoset në gojën e hapur dhe pastaj e forcojmë me buzë (nuk bën fare me dhëmbë as me gjuhë).*

Koka lehtësisht përulet prapa. Nga mushkëritë nxirret fryma ngadalë duke i zbrazur ato sa të jetë e mundur më shumë. Merret frymë thellë dhe gjatë kësaj frymëmarrjeje përdoret aerosoli, duke mbajtur gjuhën poshtë. Pas përdorimit fryma duhet të mbahet për 10-15 sekonda dhe nxirret nga njëra vrimë e hundës. Pastaj shpëlahet goja me ujë të ngrohtë.

Pas çdo marrjeje të dozës duhet të presim një minutë për të marrë dozën tjetër.

Pas përdorimit të disa barnave, siç janë kortikosteroidet, patjetër duhet të pastrohet hapësira e gojës (të shpëlahet goja me ujë të ngrohtë) *për shkak të zhvillimit të infeksioneve nga myshqet. Koka e bocës duhet t*ë pastrohet në të thatë - në pozitën kur fundi i bocës nuk është në kontakt me përmbajtjen, koka *duhet të pastrohet me garzë, nd*ërsa kontrollohet boca a është e mbyllur mirë).



Pozita e kokës

Në formë të aerosolit për frymëmarrje ndodhen: *Ventolin, Becotide, Beconase, Salbutamol* etj.

SPRAJI PËR HUNDË (NAZAL)

Para përdorimit të sprajit hundët duhen të shfryen (dëliren), koka duhet të qëndrojë e përulur lehtësisht përpara. Spraji para përdorimit duhet të tundet dhe maja e tij vendoset në një nga vrimat e hundës, ndërkohë që vrima tjetër e hundës dhe goja duhet të jenë të mbyllura. Flakoni shtypet dhe lehtësisht nuhatet për pak momente. Me largimin e majes së sprajit kokën duhet ta përulim përpara në mes gjunjve për disa sekonda dhe pastaj qëndrojmë drejt. Maja e sprajit duhet të pastrohet.

Përdorimi i preparateve të aerosolëve-sprejit për hundë

Para se t'i përdorim nga farmacisti duhet të kërkojmë këshilla:

- a ka nevojë që bari të përzihet para përdorimit;
- si të veprohet me bocën para se të përdoret (të hiqet kapaku mbrojtës, të kapet boca në pozicionin e duhur);
- si duhet të mbahet pozita e bocës (vendoset maja në hundë dhe truset mekanizmi);
- si duhet të qëndrojmë në momentin e qitjes në hundë (duke mbyllur vrimën tjetër dhe gojën, truset mekanizmi dhe nuhatet për pak kohë, pastaj koka vihet në pozicionet sikur për pikat për hundë);
- Nëse duhet të merren dy doza, doza e dytë merret 30 sekonda pas të parës;
- a duhet të nuhatet me hundë (frymë merret me gojë);
- sa herë duhet të përdoret - në cilin interval kohor;
- a mund ta përdorin dy persona të njëjtën bocë (jo).

Koka ulet lehtë përpara. Spraji para përdorimit duhet të tundet dhe maja e tij vendoset në një nga vrimat e hundës, ndërkohë që vrima tjetër e hundës dhe goja duhet të jenë të mbyllura. Flakoni shtypet dhe nuhatet lehtë për pak kohë.

Me largimin e majës së sprajit, kokën duhet ta përulim përpara në mes gjunjëve për disa sekonda

Pastaj qëndrojmë drejt

PIKAT PËR HUNDË (RHINOGUTTAE)

Pikat për hundë janë preparate mjekuese për përdorim në hapësirat e hundës. Zakonisht janë tretësira ujore të lëndëve mjekuese ose tretësira të lëndëve mjekuese në glicerinë ose propilenglikol. Mund të përgatiten edhe në formë të tretësirave vajore, mirëpo duhet pasur kujdes që mos të arrijnë deri në bronke, sepse rrezikojnë të shkaktojnë kallje (inflamim).

Pikat për hundë përmbajnë antiseptikë, anestetikë lokalë dhe vazokonstriktorë.

Pas përdorimit pikatorja shpëlahet me ujë të vëluar.

Në formë të pikave për hundë ndodhen: *Otricorten, Efedrin, Adrianol, Nafazol, Benil, Operil, Rinasekt, Rinalek* etj.

Mënyra e përdorimit

Përdorimi i pikave për hundë duhet të bazohet në përdorimin e drejtë dhe në kohën e caktuar të përdorimit. Praktika ka treguar se pikat për hundë përdoren në mënyrë të gabuar, duke e kthyer vetëm kokën mbrapa ose duke vënë kokën mbi jastëk dhe duke hedhur pikat në hundë. Mirëpo, duke pasur parasysh anatominë e hundëve dhe të vendeve të cilat sulmohen më tepër nga mikrobet, pikat duhet të merren në këtë mënyrë: së pari bëhet pastrimi i hundëve. Koka duhet

të pozicionohet sa të jetë e mundur prapa shpinës, atëherë qiten pikat (zakonisht 2-3 pika). Në momentin e qitjes, koka kalon në pozicionin e poshtëm-sa të jetë e mundur koka të afrohet në mes gjunjëve dhe ashtu duhet të qëndrojë për 3-5 sekonda, pastaj kthehet në pozicionin normal. Kjo bën të mundur që pikat të shkojnë në hejet e hundës, ku më së shpeshti lokalizohet infeksioni dhe pamundëson kalimin e pikave në traktin respirator dhe digjestiv.

Pas përdorimit pikatorja shpëlahet me ujë të vëluar.

Pikat (te ftohjet dhe rrufa) nuk duhet të përdoren më shumë se 5 (pesë) ditë, sepse mund të dëmtojnë mukozën ose të krijojnë varshmëri të përdorimit.

Pikat e përdorura nuk bën t'i përdorë një person tjetër.

Pikat pa konsultën e mjekut nuk duhet t'i përdorin fëmijët më të rinj se 12 vjeç.

Duhet të ruhen në vende të mbrojtura nga drita dhe temperatura.

Koka duhet të pozicionohet sa të jetë e mundur prapa shpinës, atëherë qiten pikat (zakonisht 2-3 pika)

Në momentin e qitjes, koka kalon në pozicionin e poshtëm-sa të jetë e mundur koka të afrohet në mes gjunjëve dhe ashtu duhet të qëndrojë për 3-5 sekonda,

Pastaj qëndrojmë drejt

PIKAT PËR VESH (OTOGUTTAE)

Pikat për vesh janë preparate mjekuese për t'u pikur në kanalin e veshit. Janë tretësira ujore, ujore-etanolike (alkoolike) ose tretësira të lëndëve mjekuese në glicerol apo në propilen glikol. Zakonisht përmbajnë antiseptikë, antiflogjistikë, kortikosteroide, antibiotikë etj.

Para përdorimit pikat për vesh duhen të ngrohen pak duke i mbajtur në dorë ose nën sqetull për disa minuta. Është mirë që i sëmuri të shtrihet anash në mënyrë që veshi i sëmurë të jetë lart. Lapa e veshit duhet të tërhiqet lart, në mënyrë që të zbulohet e të hapet kanali i veshit. Pastaj hidhen pikat e përshkruara dhe pritet pesë minuta për të vazhduar pastaj me veshin tjetër.

Në formë të pikave për vesh ndodhen: *Otomicin, Otol H, Dexamethason –Neomycin, Gentamicin, Bivacyn* etj.

Para përdorimit pikat për vesh duhen të ngrohen pak duke i mbajtur në dorë ose nën sqetull për disa minuta.



I sëmuri shtrihet anash në mënyrë që veshi i sëmurë të jetë lart. Lapa e veshit duhet të tërhiqet lart, në mënyrë që të zbulohet e të hapet kanali i veshit. Pastaj hidhen pikat e përshkruara dhe pritet pesë minuta për të vazhduar pastaj në veshin tjetër.

PREPARATET PËR SY

Syri është organi më i ndieshëm i organizmit. Duke pasur parasysh ekzistencën e një rreziku të përhershëm të infektimit dhe iritimit të syrit edhe gjatë aplikimit të çfarëdo bari në sy, sidomos kur syri është i lënduar ose i sëmurë, duhet të sigurohet një sterilizim i plotë dhe ruajtje e këtij steriliteti gjatë gjithë kohës së përdorimit të preparatit për sy, si kërkesë e domosdoshme.

Në praktikën mjekësore sot shfrytëzohen këto preparate në formë pikash për sy (oculoguttae, oculostiae):

a. Tretësirat ujore (për sy - colyria – koliret, oculobalenea) dhe

b. Tretësirat vajore (për sy-oculenta)

PIKAT PËR SY (OCULOGUTTAE)

Pikat për sy janë preparate të lëngëta mjekuese, të cilat shërbejnë për t'u pikur në pjesën konjuktivale të syrit.

Zakonisht janë tretësira ose suspensione të lëndëve mjekuese të tretura në ujë ose vaj neutral. Më së shpeshti përmbajnë antiseptikë lokalë, anestetikë lokalë, midriatikë (zgjerues të bebzës së syrit), miotikë (ngushtues të bebëzës së syrit), vazokonstriktorë, kortikosteroide dhe antibiotikë. Dozohen me pika.

Pikat për sy pranohen lehtë, syri i duron mirë, nuk e pengojnë shikimin

dhe nuk e dëmtojnë epitelin. Mirëpo kanë edhe anë negative për shkak të qëndrimit të shkurtër në vendin e aplikimit, prandaj edhe duhet të përdoren shpesh.

Kur përdorim pikat për sy duhet të kemi kujdes në:

- duart-duhet të jenë të pastra.
- koka çohet pak mbrapa (ose te fëmijët shtrihet drejt)
- mosprekjen me dorë të vendit ku dalin pikat. Syri duhet të shikojë lart, ulët poshtë kapaku i poshtëm i syrit duke krijuar një "ulluk"(hullizë), pa e prekur syrin,
